

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7856 E premte 19 Prill 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** Ditës
Në qershor të vitit 2014, disa ditë përpara se Shqipëria të merrte Statusin e vendit Kandidat për në Bashkimin Europian, unë botova një shkrim - po në "Gazetën Shqiptare" ... Vijon në faqen 20

Nga FLUTURA AÇKA
Ç'faj na ka Holanda


Opinion **i** Ditës
Megjithëse Sali Berisha e ka quajtur "e bija e të atit", duke iu referuar kokëçarjeve që ish-themluesi i PD-së i sillte partisë së tij, Rudina Hajdari nuk ... Vijon në faqen 21

Nga ANDI BUSHATI
Mos e thërrisni më Rudina e Azemit




"Largimi i Ramës, kusht i panegociueshëm"
PD-LSI: Blllokojmë me çdo mjet zgjedhjet farse të 30 qershorit

"Rama ik", protesta e madhe më 11 maj.
OSBE: Klima e polarizuar dëmton procesin

Nga VALENTINA MADANI

Opozita do të blllokojë me çdo mjet zgjedhjet e 30 qershorit. Ky është vendimi i marrë dje nga forumet e larta të PD-së. Partia Demokratike e kushtëzoi hyrjen në zgjedhjet lokale të 30 qershorit me plotësimin e tri çështjeve, që sipas saj garantojnë ...

Në faqen 5

LISTA E RE/ MINISTRIA E FINANCAVE: PERFITUESIT E KESTIT TE TRETE TE DEMSHPERBLIMIT

ISH-TE PERNDJEKURIT, 500 EMRAT QE MARRIN PARATE

Trashëgimtarët e ish-të dënuarve politikë që marrin paratë. Duhet dorëzuar certifikata dhe llogaria bankare aktive në drejtorinë e përfitimeve



(Në foto) Ish-të përndjekur politikë

Në faqen 10

INTERPELANCA

Lleshaj: Grabitësit ishin profesionistë, përdorën një tunel për t'u larguar

Në faqen 2

SULMI MBI POLICINE

Dëshmia e shefit të Antidrogës, Ylli Bici: Në "Audi" nuk ishte Suel Çela

Në faqen 6

KUSHTET E VESHITRA

"Familjet e shqiptarëve të ISIS në Siri, rruga e gjatë e kthimit për në shtëpi"

Në faqen 7

RAPORTI

EUROSTAT, për Shqipërinë: U rritën ushqimet dhe qiraja

Në faqen 8

RAPORTI



Alarmi i "Reportere pa kufij": Gazetarët në Shqipëri kërcënohen

Në faqen 4

Kryeministri në seancë: Qëndrimi i Holandës, pjesë e debateve të brendshme

Rama: BE nuk do rikthejë vizat për shqiptarët

Opozita krijon 2 grupe parlamentare, Kuvendi shkon në 109 deputetë

Kryeministri Edi Rama është i bindur se vendimi i Parlamentit të Holandës për rikthimin e vizave nuk do të ketë asnjë ndikim në lëvizjen e lirë të shqiptarëve në zonën "shengen". Nga foltorja e Kuvendit, kreu i qeverisë ka folur gjatë për këtë vendimarrje të de-



putetëve holandezë, duke theksuar se rikthimi i vizave varet nga të tjera kriteret dhe që s'kanë të bëjnë me situatën e kriminalitetit në një vend të caktuar të BE-së. "Është një procedurë parlamentare, e cila nuk ka asnjë implikim të drejtpërdrejtë në ...

Në faqen 3

KUVENDI OPOZITA E RE

Ministri ka deklaruar se koncesionarit i janë vënë në dukje 12 mangësi

Lleshaj: Grabitësit ishin profesionistë, përdorën një tunel për tu larguar

Portat, gardhi, ndriçimi dhe kamerat, disa nga problemet

Grabitja e më shumë se 6.5 milionë eurove javën e shkua në aeroportin e Rinasit është kryer nga profesionistë. Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj është paraqitur dje në një interpelancë të thirrur nga deputetët e opozitës, Ralf Gjoni dhe Myslim Murrizi, ku i është përgjigjur pyetjeve të tyre lidhur me vjedhjen spektakolare të ndodhur brenda pistës së aeroportit ndërkombëtar të Rinasit. Që në nisje të kësaj interpelance, deputeti Ralf Gjoni i ka bërë një sërë pyetjesh ministrit, ndërsa theksoi se kjo ngjarje tregoi brishtësinë dhe problemet e sigurisë së aeroportit dhe të vetë sigurisë kombëtare. Në përgjigjet e tij ministri Lleshaj i qëndroi edhe një herë deklaratave të tij të mëparshme, ndërsa theksoi se grabitja e 9 prillit, nuk është një ngjarje apokaliptike dhe se siguria e vendit nuk cenohet nga një grup prej 5 vetësh të armatosur. "Ngjarja është e njohur, por është dëshmi i një serie dështimesh që janë përgjegjëse për sigurinë në aeroport. Me ligjin i miratur para 15 viteve, përgjegjësia i është transferuar kontraktorit privat, nuk do ta kisha votuar kurrë këtë vendim, por duhet ta dini se vendimi për këtë, është marrë në këtë Kuvend dhe është pranuar, toleruar, pëlqyer 15 vite me radhë dhe ju e dini fort mirë se kush ka qenë në karrige gjatë 15 viteve", - tha Lleshaj. Më tej ai bëri të ditur se koncesionari dhe operatori privat i sigurisë lajmëroi policinë vetëm pas 5 minutash pasi kishte ndodhur ngjarja, ndërkohë që forcat e rendit nuk u lanë të futeshin në pistë. "Operatori privat ka njoftuar 5 minuta e 21 sekonda më vonë policinë e shtetit, pasi kishte marrë në rrugë të treta njoftimin. TIA ka njoftuar avionin 30 minuta pasi ka ndodhur ngjarja. Kontraktori privat nuk ka lejuar forcat e ndërhjës së shpejtë të hyjnë, porta nuk është hapur dhe e ka nën komandë kompania", - tha Lleshaj. Lleshaj ka sjellë dhe detaje nga operacioni për kapjen e autorëve, duke theksuar se ata ishin profesionistë dhe mundën të largohen duke përdorur një tunel të ushtrisë. "S'kemi pas njoftim nga ata që duhet ta kishim, por prapë ndërhymë. Ka pasur përplasje me armë, ka mbetur një i vrarë. Ka qenë një krim i organizuar mirë, ka pasur përpjekje për të devijuar vëmendjen e Policisë së Shtetit. Pas kësaj kanë hyrë brenda një tuneli ushtrie të braktisur. Megjithatë kemi besim se ngjarja do zbardhet plotësisht. Dua të them se nuk kemi të bëjmë me një rast të thjeshtë. Autorët ishin profesionistë, kanë shpërthyer edhe një burg në një nga vendet e BE.



Ministri i Brendshëm,
Sandër Lleshaj

Ndjekja

"S'kemi pas njoftim nga ata që duhet ta kishim, por prapë ndërhymë. Ka pasur përplasje me armë, ka mbetur një i vrarë. Ka qenë një krim i organizuar mirë, ka pasur përpjekje për të devijuar vëmendjen e Policisë së Shtetit. Pas kësaj kanë hyrë brenda një tuneli ushtrie të braktisur. Megjithatë kemi besim se ngjarja do zbardhet plotësisht. Dua të them se nuk kemi të bëjmë me një rast të thjeshtë. Autorët ishin profesionistë, kanë shpërthyer edhe një burg në një nga vendet e BE.



Gjatë një seance
parlamentare

Shkon në 109 numri i përgjithshëm i anëtarëve të Kuvendit

Opozita e re krijon dy grupe parlamentare, PD e tradhetojnë 3 aleat

Opozita e re parlamentare ka ngritur grupet e saja parlamentare. Deputetët e rinj janë grupuar në dy grupe parlamentare, ai i "Demokratëve" dhe ai i "Pavarur". Në grupin e demokratëve hyjnë të gjithë deputetët e rinj, që vijjnë nga lista e Partisë Demokratike dhe në grupin e të pavarurëve hyjnë deputetët që kanë ardhur nga lista e LSI-së. Grupi i Demokratëve do të drejtohet nga vajza e Azem Hajdarit ndërsa Grupi i të Pavarurëve do të drejtohet nga Nimet Musai që vjen nga radhët e LSI-së. Lajmin e krijimit të grupeve e bëri të ditur dhe kryetari i Kuvendit Gramoz Ruci në nisje të seancës, ndërkohë që menjëherë pas kësaj administrata e Kuvendit bëri dhe publikimet e tyre në faqen zyrtare në internet. Konkretisht Grupi Parlamentar Demokratik përvëç Rudina Hajdarit ka në përbërje anëtarët: Myslim



Murrizi, Korab Lita, Arben Elezi, Arlind Çarçani, Halil Jakimi dhe Artan Zeneli. Ndërsa Grupi i Pavarurëve përvëç Nimet Musait ka në përbërje Edlira Hyseni në pozicionin e zëvendës kryetarit, Enver Roshin si sekretar politik dhe anëtarë: Ralf Gjoni, Adiola Braha, Ylli Shehu dhe Aurora Mara. Natyrisht që numri i anëtarëve të këtyre dy grupeve pritet të rritet në ditët në vijim, pasi një numër i konsiderueshëm deputetë pritet të hyjnë në parlament.

Kështu dje KQZ miratoi vendimin për t'i dhënë mandatin 4 deputetëve të rinj. Ata janë Floriana Dhimitri nga lista shumë emërore e PD Gjrokastër, Andi Përmeti nga lista e PD Korçë, Eugen Bojaxhi nga lista e LSI, Berat dhe Erion Piciri nga lista e PD Tiranë. Por numri i deputetëve opozitar do vijojë të rritet edhe më tej pasi 3 kandidatë të tjerë, kryetar partish aleatë të PD-së kanë dorëzuar formularin e deklarimit të mandatit për të marrë mandatin e deputetit. Ata janë Artur Roshi, kryetari i Partisë Balli Kombëtar Demokrat, kandidat për deputet në listën e PD, qarku Tiranë, Nikolin Staka kandidat në listën e PD, qarku Shkodër dhe Zef Shtjefni kandidat në listën e PD, qarku Shkodër. Së bashku me ta numri i përgjithshëm i deputetëve në Kuvend shkon në 109, nga të cilët 30 opozitar.

është përgjegjëse për sigurinë në aeroport. "Zona e aeroportit me ligj është përgjegjësi e koncesionarit, ndërsa jashtë saj e policisë së shtetit. Ka pasur një seri

Murrizi: Grabitja ka pasur informator nga brenda aeroportit

Deputeti demokrat, Myslim Murrizi, një nga deputetët që thirrën interpelancën e djeshme me ministrin e Brendshëm Sandër Lleshaj, i ka kërkuar këtij të fundit të mbajë përgjegjësi për ngjarjen e ndodhur në Rinas dhe grabitjen e afro 6.5 milionë eurove. Ndër të tjera Murrizi u shpreh i gatshëm se, nëse nga analiza e ngjarjes rezultojnë se përgjegjësia është e koncesionarit, të votonte prishjen e saj në Kuvend. "Çfarë informacioni keni për kompaninë ICTS-së, çfarë është kjo kompani dhe si i merr njerëzit në punë? Nëse mendoni se e keqja është koncesioni, e jani silleni në Kuvend ta anulojmë. Nëse merreni me ata që hedhin bojë, apo urinojnë nëpër lulishte, nuk ju shtyn kureshtja që të shihni kush punon në aeroport, këta që ju heqin rripin e pantallonave shqiptarëve, që ju vjedhin celularët, që ju heqin fasulet dhe gjelin e detit, nuk keni ju fare të dhëna... Grabitja ka pasur kallauzë nga brenda, ju çka na thoni ka pasur informatorë aty apo jo, gjithçka ka ndodhur në 2 minuta e 30 sekonda, kush është kjo kompani që nuk i hap derën FNSH?", - u shpreh Murrizi.



komunikimesh mes policisë dhe operatorit, janë rreth 12 komunikime ku policia kërkon marrje mashash, ndërsa në korrespondencën TIA ose është shprehur se nuk jeni ju organi për t'u marrë ose është heshtur", - u shpreh Lleshaj. Por pavarësisht se kanë kaluar rreth 10 ditë nga supergrabitja në Rinas, ministri i Brendshëm edhe në këtë interpelancë, nuk e dha një shifër të saktë parave të grabitura, ndërsa tha se u grabit një sasi e konsiderueshme vlere monetare.

Ministri shtoi se ndaj koncesionarit dhe TIA-s janë bërë detyrime konkrete për disa nga pikat që nuk përbushnin parametrat e sigurisë në aeroport. "Vazhdimisht janë bërë vlerësimet ndaj TIA që lidhen me portat që nuk sigurojnë parametrat e sigurisë, rrethimi i jashtëm pa sensorë, shumë kamera janë jashtë funksionit, zona e transitit me probleme, pista e pandriçuar mirë", - tha Lleshaj.



Kreu i qeverisë u shpreh se qëndrimi i Holandës është produkt i debateve të brendshme

Rama: Vendimi për vizat nuk prek lëvizjen e lirë të shqiptarëve

"Shqiptarët janë zgjedhur në atë vend si një kokë turku"

Kryeministri Edi Rama është i bindur se vendimi i Parlamentit të Holandës për rikthimin e vizave nuk do të ketë asnjë ndikim në lëvizjen e lirë të shqiptarëve në zonën "shengen". Nga foltorja e Kuvendit, kreu i qeverisë ka folur gjatë për këtë vendimmarrje të deputetëve holandezë, duke theksuar se rikthimi i vizave varet nga të tjera kritere dhe që s'kanë të bëjnë me situatën e kriminalitetit në një vend të caktuar të BE-së. "Është një procedurë parlamentare, e cila nuk ka asnjë implikim të drejtpërdrejtë në lëvizjen e lirë të shqiptarëve dhe për të shpjeguar pak më konkretisht, të gjithë duhet ta kenë parasysh se për revokimin e lëvizjes së lirë duhet të përmbushen disa kritere objektive, asnjë prej të cilave nuk përkon me realitetin e faktorit - nëse mund ta quajmë kështu, - shqiptar, në Holandë", - tha kryeministri Edi Rama. Më tej, ai shtoi se shqiptarët në Holandë janë zgjedhur si një element nga grupime të caktuara politike holandeze, që kërkojnë t'i përdorin për të përfituar kapital politik. "Shqiptarët janë zgjedhur nga disa parti në atë vend si një kokë turku për retorikën agresive izolacioniste, në raport me zhvillimet përtej kufijve të Holandës, në Bashkimin Europian dhe agresive kundër politikës europiane të zgjerimit", - u shpreh kryeministri.



Kryeministri Edi Rama

PAKETA "ANTISHPIFJE"
"Ne këtu do të vijmë shumë shpejt me ligjin kundër shpifjes dhe për të rregulluar të gjithë aktivitetin e mediave 'online'. Nuk mundet dot të vazhdojmë të jemi mish për top i kujtdo që i teket të shpifë, të sajojë, të na futet nëpër shtëpia e të sakatojë të madh e të vogël në emër të lirisë".

OPOZITA

"E kam thënë dhe e përsëris, qeverisë nuk kanë çfarë t'i bëjnë dhe kjo është më e pakta. Nuk e ndryshojnë dot qeverinë me kapsolla, nuk e ndryshojnë dot qeverinë duke kënduar himnin stonato. Sado stonato ta këndojnë himnin kombëtar, qeveria nuk lëviz. Nuk e ndryshojnë dot qeverinë duke kërcënuar, shantazhuar, penguar, duke bllokuar. Nuk e ndryshojnë dot shumicën në këtë parlament, s'kanë se si, është e pamundur", - tha Rama.



Vendimi, Qeveria, 4 mln euro për televizionet

"2 mln euro jepen për tv kombëtare dhe 2 për ato me eksperiencë"

Qeveria do të shpërndajë për televizionet private kompenzim në shumën e 2 milionë euro si kompensim për procesin e ndërrimit të sistemit të transmetimit nga analogë dhe numerikë. Ky është vendimi më i fundit i qeverisë i marrë me 4 prill dhe që dje është botuar në Pletoren Zyrtare. Në bazë të kësaj VKM-je, qeveria vendos ndarjen e kompensimit financiar për kategoritë operatorë privatë historikë kombëtarë dhe operatorë me eksperiencë në transmetimet numerike. Më konkretisht operatorët me eksperiencë në transmetimet numerike të kompensohen në masën 2 000 000 (dy milionë) euro, për mbulimin e pjesshëm të investimeve që dalin jashtë funksionit si rezultat i ndryshimeve teknologjike, sipas ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë". Gjithashtu, ky vendim përcakton se operatorët privatë historikë kombëtarë të kompensohen në masën 2 000 000 (dy milionë) euro, për mbulimin e pjesshëm të investimeve të kryera për ndryshimin e infrastrukturës së transmetimit, nga analoge në numerike. Vlera e kompensimit për operatorët me eksperiencë në transmetimet numerike do të logaritet me përqindjen që vlera financiare për përgjegjësitë tatimore, e paguar prej secilit operator, zë në totalin e vlerës financiare për përgjegjësitë tatimore të paguara nga të gjithë operatorët me eksperiencë në transmetimet numerike.

Soreca: Duam që kjo opozitë të shkojë në zgjedhjet lokale

Ambasadori i Bashkimit Europian në vendin tonë, Luigi Soreca, reagoi dje pas krijimit të dy grupeve të reja parlamentare në Kuvend, që përfaqësojnë PD dhe LSI, konkretisht grupi parlamentar Demokrat, që kryesohet nga Rudina Hajdari dhe grupit të pavarur që ka si kryetar Nimet Musain. Ai kërkoj që kjo opozitë e re të shkojë në zgjedhje dhe të paraqitet si një alternativë para shqiptarëve. "Duam që kjo opozitë të shkojë në zgjedhjet lokale. Ne shpresojmë se opozita do të marrë pjesë në zgjedhje", - u shpreh Soreca. Një thirrje kjo, që tregon se BE-ja po kërkon të mbështesë krijimin e një opozite të re. Shpeshherë përfaqësues të faktorit ndërkombëtar kanë takuar dhe inkurajuar deputetët e rinj që të bëhen pjesë e jetës par-



tucionet dhe të bojkotojë zgjedhjet. Natyrisht që ndërkombëtarët duket se janë të vendosur dhe të paturësuar për krijimin e një krize më të thellë politike në vend, ndaj dhe në mungesë të opozitës reale, po mbështesin krijimin e një opozite të re. Shpeshherë përfaqësues të faktorit ndërkombëtar kanë takuar dhe inkurajuar deputetët e rinj që të bëhen pjesë e jetës par-

lamentare. Tashmë ata kërkojnë që ata të bëhen pjesë edhe të zgjedhjeve të ardhshme. Por, që ata të bëhen pjesë e kësaj gare elektorale ose duhet të krijohet subjekte politike, ose të mbështesin kandidatët e pavarur. Kujtojmë këtu se Kodi Zgjedhor përcakton të dielën e ardhshme si afatin e fundit të regjistrimit të partive në zgjedhje.

i atij vendimi. Një festë fyese dhe besoj pa e ekzagjeruar aspak, deri përbuzëse për njerëzit e zakonshëm të këtij vendi", - shtoi Rama. Sipas tij, opozita nuk ka se çfarë t'i bëjë qeverisë, pavarësisht përpjekjeve për të përfituar edhe nga vendime të tilla, që në thelb janë vendime kundër shqiptarëve. "E kam thënë dhe e përsëris, qeverisë nuk kanë çfarë t'i bëjnë dhe kjo është më e pakta. Nuk e ndryshojnë dot qeverinë me kapsolla, nuk e ndryshojnë dot qeverinë duke kënduar himnin stonato. Sado stonato ta kënd-

ojnë himnin kombëtar, qeveria nuk lëviz. Nuk e ndryshojnë dot qeverinë duke kërcënuar, shantazhuar, penguar, duke bllokuar. Nuk e ndryshojnë dot shumicën në këtë parlament, s'kanë se si, është e pamundur", - tha Rama. Ndërkohë që duke folur për një nga shqetësimet kryesore të opozitës që ka të bëjë me shpërblen e votave, Rama tha se mazhoranca ishte gatë miratonte forcim të penalliteteve në Kodin Penal. "Ne kemi mundësi së bashku të adresojmë në Kodin Penal shumë shpejt disa masa të reja

për integritetin votës, shitblerjen e votës", - tha kryeministri. Ndërkohë, ndonëse mazhoranca është shprehur e gatshme të diskutojë për ndryshimin e sistemit zgjedhor, Rama theksoi se PS-ja është kundër një sistemi tjetër. "Ne nuk jemi dakord, por mënyra jonë për të mos qenë dakord nuk është që të mos i japim mundësi palës tjetër; që të thotë çfarë mendon dhe çfarë kërkon, si e kërkon dhe ta argumentojë. Ne jemi të hapur që të diskutojmë pa qenë të detyruar të biem dakord", - tha Rama.

LIRIA E MEDIAS RAPORTI


Raporti: Sulmi ndaj medias nga qeveria dhe krimi i organizuar në një nivel të paprecedent

Valentina Madani

Shqipëria ka njohur zbritje përsa i përket lirisë së medias. "Reporter pa Kufij", organizata e njohur për mbrojtjen e lirisë së medias publikoi dhe indeksin botëror të lirisë së medias, në të cilin Shqipëria ka një rënie me 7 vende, duke u renditur në vendin e 82-të. Duke iu referuar pikërisht Shqipërisë, "Reporterët pa Kufij" shprehen se politikanët, të udhëhequr nga kryeministri Edi Rama i quajnë gazetarët kuzin dhe prodhues lajmesh të rreme. Organizata thekson se sulmet ndaj medias si nga qeveria, ashtu edhe nga krimi i organizuar arritën në një nivel të paprecedent në 2018. "Gazetarët iu nënshtruan fyerjeve, kërcënimeve me vdekje dhe procedimeve ligjore, që synojnë t'i frikësojnë dhe t'i frenojnë ata nga investigimi i korrupsionit", shkruan "Reporterët pa Kufij". Kryeministri ka propozuar një ligj, që ka për qëllim të forcojë kontrollin e shtetit mbi mediat elektronike dhe të kufizojë aksesin të lajmet dhe informimit", shton raporti. Sipas "Reporter pa Kufij", liria e medias është e censuruar, ndërsa gazetarët intimidohen dhe kërcënohen si nga qeveria, ashtu edhe nga krimi i organizuar. "Rruga për në BE është e gjatë", shprehet "Reporter pa Kufij" teksa vijon me faktin vetëcensura është gjerësisht e përhapur dhe 80% e gazetarëve nuk kanë besim për të ardhmen e tyre profesionale. "Sulmet në media si nga qeveria, ashtu edhe nga krimi i organizuar arritën në një nivel të paprecedent në 2018. Gazetarët iu nënshtruan fyerjeve, kërcënimeve me vdekje dhe procedimeve ligjore, që synojnë t'i intimidojnë dhe t'i frenojnë ata nga investigimi i korrupsionit". Organizata sjell në vëmendje edhe raportin e përbashkët të publikuar me BIRN, në mars 2018, duke theksuar se standardet rregullatore të medias po manipulohen në favor të interesave të qeverisë. Një raport i përbashkët i publikuar nga "Reporterët pa Kufij" dhe BIRN në mars 2018 nxori në pah një numër kërcënimesh që i janë bërë medias në Shqipëri. Raporti gjeti se standardet rregullatore të medias po manipulohen në favor të interesave të qeverisë dhe pronësia e mediave televizive është përqendruar në duart e pak biznes-

Alarmi i "Reporter pa Kufij": Në Shqipëri gazetarët kërcënohen

"Shqipëria humb 7 vende në lirinë e medias"



AMERIKA

Si rezultat i një klime gjithnjë e më armiqësore që shkon përtej komenteve të Donald Trump, Shtetet e Bashkuara (48) kanë rënë tri vende në indeksin e këtij viti dhe klima e medias tani është klasifikuar si "problematiche" (portokalli). Asnjëherë më parë gazetarët amerikanë nuk kanë pasur kaq shumë kërcënimeve me vdekje, ose janë kthyer aq shpesh të firmat private të sigurisë për mbrojtje.



Një nga protestat e fundit të opozitës

Shqipëria humbi 7 vende në lirinë e medias, Meta: Kambanë alarmi, duhet të na zgjojë

Presidenti i Republikës, Ilir Meta, reagoi dje pas publikimit të indeksit të lirisë së medias, ku Shqipëria ka humbur 7 pozicione. Në një reagim, kreu i shtetit shprehet se kjo është një kambanë alarmi, që duhet të na zgjojë të gjithëve. "Zbritja me 7 vende në Indeks Botëror të Lirisë së Medias dhe paralajmërimi serioz i këtij raporti se rruga e Shqipërisë për në BE është e gjatë, është një kambanë e fortë alarmi që duhet të na zgjojë të gjithëve. Angazhimi i institucioneve dhe i shoqërisë në përkrahje të lirisë së shprehur është tregues



për demokracinë, qeverisjen e mirë dhe përgjegjësinë publike në vend. Nuk duhet të harrojmë se liria e të shprehurit është e drejtë themelore e njeriut dhe shtyllë e pazëvendësueshme e jetike për një shoqëri moderne demokratike", thuhet

TAKIMI

Presidenti Ilir Meta priti dje kreun e Komunitetit Mysliman Shqiptar, Haxhi Bujar Spahiu. Meta vuri në dukje domosdoshmërinë e intensifikimit të përpjekjeve për të bërë të mundur kthimin e pronave Bashkësive Fetare dhe kompensimin e tyre sa më parë.

në reagimin e presidentit, duke përmendur nën 49 të Traktatit të Lisbonës, i cili e përcakton qartë garantimin e lirisë së shprehjes dhe një vend, i cili synon t'i bashkohet BE-së duhet të respektojë garantimin e saj.

menëve të mëdhenj. Kjo ka krijuar një situatë në të cilën vetëcensura është gjerësisht e përhapur dhe 80% e gazetarëve nuk kanë besim për të ardhmen e tyre profesionale", thuhet në artikullin referuar Shqipërisë. Ndërkohë, "Reporterët pa Kufij"

shprehen se indeksi i lirisë së medias për vitin 2019 në të gjithë botën është futur në një cikël frike. "Indeksi i lirisë së medias në botë për vitin 2019, i përpiluar nga Reporterët pa Kufij (RSF) tregon se si urretjtja ndaj gazetarëve është degjeneruar në dhunë, duke

kontribuar në rritjen e frikës. Numri i vendeve që konsiderohen të sigurta, ku gazetarët mund të punojnë në siguri të plotë vazhdon të bjerë, ndërsa regjimet autoritare vazhdojnë të forcojnë kontrollin e tyre në media", thuhet në shkruar.

SHKURTE

"S'mund të jemi më 'mish për top", Rama: S'ka media të shantazhuar

Kryeministri Edi Rama shprehu dje sigurinë e plotë se nuk ka media të shantazhuara në Shqipëri dhe as liri të mohuar. Rama reagoi në "Twitter" pas publikimit të raportit për lirinë e medias në vend nga organizata botërore "Reporterët pa Kufij". Rama iu përgjigjet dhe gjithë kritikëve dhe atyre që bëjnë moral, duke i quajtur "virgjërshë" e duke i akuzuar se rrihinin e plagosnin gazetarët. "Një pasqyrë kujtese 'virgjërshë' që vrisnin aqytetarë, rrihinin e plagosnin gazetarë dhe sot bëjnë moral! Ka ende shumë për të bërë për lirinë e medias dhe ndarjen e lumit të informacionit nga lumi i kazarit po ashtu. Por me këtë qeveri s'ka media të shantazhuar e liri të mohuar!", shkruan Rama teksa publikoi edhe një renditje të Shqipërisë për lirinë e medias nga viti 2014 deri në vitin 2018. Nga kjo renditje shihet se Shqipëria në vitin 2014, kur PS mori pushtetin ishte në vendin e 85-të, ndërsa në 2018 megjithëse ka rënë është në vendin e 82-të. Më herët në Kuvend, kreu i qeverisë, Edi Rama u zotua se nuk do të tërhiqet nga projektligji kundër shpifjes në media, si dhe për rregullimin e mediave 'online'. "Do të vijmë shpejt me ligjin kundër shpifjes, shumë shpejt do të rregullojmë edhe mediat 'online'. S'mund të jemi më mish për top, të sakatohemi në emër të lirë, siç këtu do vijmë shumë shpejt", - tha Rama.

PD, ambasadorëve: Monitoroni situatën e rëndë të medias në Shqipëri

Partia Demokratike denoncoi dje situatën alarmante të lirisë së medias në Shqipëri. Ish-deputetja demokratike, Albana Vokshi, reagoi për raportin e organizatës "Reporterët pa Kufij", sipas të cilit, Shqipëria zbritet me 7 vende në Indeks Botëror për Lirinë e Medias. Ajo akuzoi kryeministrin Edi Rama se ka forcuar kontrollin qeveritar mbi median. "Sulmet ndaj medias si nga qeveria, ashtu edhe nga krimi i organizuar arritën në një nivel të paprecedent në vitin 2018. Në publikimin e Indeksit Botëror të Lirisë së Medias, Shqipëria ka zbritur 7 vende, duke parë si përgjegjës kryesor Kryeministrin Edi Rama. Ai ka vënë nën kontroll shumicën prej tyre nëpërmjet lidhjeve me pronarët oligarkë, tenderave, koncesioneve, PPP-ve apo licencave korruptive, siç evidentohet në raport. 'Reporterët pa Kufij' shprehin shqetësimin për kapjen e mediave dhe përqendrimin e tyre në duart e një grushti biznesmenësh të mëdhenj", u shpreh zj. Vokshi. Në raport, Shqipëria renditet në vendin e 82 në Indeks Botëror të Lirisë së Medias.

Shitje me Ankand të dyte nga Studio Permbartore L.D.C

Shitje me Ankand të dyte nga Studio Permbartore L.D.C
- "Trulli + ndertese" me nr. pasurie 286/51, vol.3, fage 36, Zona Kadastrale. 3866, me sipërfaqe totale 300 m², regjistruar ne Z.V.R.P.P. Tirane. Çmimi fillestar për shitje eshte 1.800.000 Lekë.
Data e shpalljes 27.02.2019
Data e zhvillimit 28.03.2019 deri ne oren 16.⁰⁰
Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Permbartore L.D.C me adrese Rruga "Myslim Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

Shoqëria permbartore JUSTITIA

Shoqëria permbartore JUSTITIA shpall ankandin, faza e trete, për shitjen e pasurisë së palaujtshme për të cilën ka vënë hipoteke BKT BANK, me këto të dhëna:
- Pasuria "KARE" nr. 175, Zona Kadastrale 3339, me sipërfaqe 7780 m² fage 190 vol.5, e ndodhur në Vrin Durrës, në pronësi të z.Adrian Selfer Kapllani dti.08.03.1969, zj.Merita Myzater Kapllani dti.24.06.1970
Në vlerën 7.308.000 (shtatë milion e treqind e tetë mijë) Lekë.
- Pasuria Apartament me sip.120m² nr.pas.4115041-1.zk.8518 vol.116 fq.54 me adresë:Plazh/13 Durrës në pronësi të z.Adrian Selfer Kapllani dti.08.03.1969.
Në vlerën 3.390.569 (tre milion e treqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë.
Ankandi zhvillohet në datën 20.05.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbartës gjyqësor me adrese Bulevardi"Bağram Curri", Pall. 21,Shk.3, Ap.18, Tiranë.

Shoqëria permbartore JUSTITIA

Shoqëria permbartore JUSTITIA shpall ankandin, faza e pare, për shitjen e pasurisë së palaujtshme për të cilën ka vënë hipoteke ABI BANK, me këto të dhëna:
- "Ara", me sipërfaqe 5.130 m², me adrese ne Piraj, Lezhë, , ne Zonën Kadastrale Nr. 2964, me Nr. Pasurie 2019/Vol.1 fq.127, në pronësi të zvj. Alma Ligji Marku.
Në vlerën 2.480.000 (dy milion e katërqind e tetëdhjetë mijë) Lekë.
- "Njësi", me sipërfaqe 191 m², me adrese ne Lagjen "Besëlidhja", Lezhë, , ne Regjistrin hipotekor Nr. 578, date 28.10.2016, ne Zonën Kadastrale Nr. 8632, me Nr. Pasurie 4/400-N11, në pronësi të Shoqërisë ENCO GROUP sh.p.k.
Në vlerën 107.200 EUR (njëqind e shtatë mijë e dyqind) EUR.
Ankandi zhvillohet në datën 03.05.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbartës gjyqësor me adrese Bulevardi"Bağram Curri", Pall. 21,Shk.3, Ap.18, Tiranë.



Tri kushtet e PD-së, Basha: Nuk hymjë në zgjedhje, qeveria transitore me socialistët

Vendimi, opozita do të bllokojë me çdo mjet zgjedhjet e 30 qershorit

"Rama ik", protesta e radhës e opozitës, më 11 maj


Valentina Madani

Opozita do të bllokojë me çdo mjet zgjedhjet e 30 qershorit. Ky është vendimi i marrë dje nga forumet e larta të PD-së. Partia Demokratike e kushtëzoi hyrjen në zgjedhjet lokale të 30 qershorit me plotësimin e tri çështjeve, që sipas saj garantojnë një proces të lirë e të ndershëm. Në të kundërt, demokratët do të pamundësojnë zhvillimin e zgjedhjeve. Kryetari i PD-së, Lulzim Basha, i propozoi kryesisë marrjen e 3 vendimeve të rëndësishme. I pari është që PD-ja të regjistrohet në zgjedhje, vetëm pasi të jenë krijuar kushtet për zgjedhje të lira: "Partia Demokratike e Shqipërisë të regjistrohet në zgjedhje vetëm pasi të jenë krijuar kushtet për zgjedhje të lira dhe të ndershme. Kriza e rëndë politike në vend nuk mundëson standardet demokratike për zgjedhje të lira dhe të ndershme. Është provuar se qeveria e Edi Ramës ka bashkëpunuar me krimin e organizuar për blerjen e votave". Pika e dytë që Basha i ka paraqitur për miratim kryesisë është që PD-ja të mos lejojë mbajtjen e zgjedhjeve fasadë, që shkatërrojnë demokracinë dhe vullnetin e qytetarëve shqiptarë. "PDSH angazhohet në mbrojtje të demokracisë dhe të drejtës së votës së lirë të mos lejojë përveç zgjedhjeve të lira, asnjë farsë elektorale. Të pamundësimit përmes përkallëzimit të aksionit opozitar dhe qytetar mbajtjen e zgjedhjeve fasadë, të diktuar nga krimi i organizuar dhe paratë e pista, që shkatërrojnë demokracinë dhe vullnetin e qytetarëve shqiptarë". Një prej kushteve për hyrjen në zgjedhje, që PD-ja e ka artikulluar edhe më herët është krijimi i një qeverie tranzitore. Për këtë, Basha ka edhe një negociator konkret. "Të mandatohet kryetarin e partisë dhe sekretarin e përgjithshëm për të negociuar me partitë politike të opozitës marrëveshjen për garantimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, për mbrojtjen e interesit publik dhe aksionin opozitar për plotësimin e këtyre objektivave, përfshirë mandatin dhe detyrat e qeverisë transitore dhe platformën për zgjedhje të lira dhe të ndershme". Është propozimi i tretë i z. Basha.

kryesisë së PD-së për të pamundësuar zgjedhjet e 30 qershorit. Pas mbledhjes së këshillit, kreu i PD-së, Lulzim Basha deklaroi se pa garantuar zgjedhje të lira dhe të ndershme, PD-ja nuk futet në zgjedhjet lokale të 30 qershorit. "Jemi i vetmi vend në botë, ku 500 mijë shqiptarë janë larguar si pasojë e një

regjimi të ardhur në pushtet me krimin e organizuar. Këshilli Kombëtar sot ka sanksionuar hapat për betejën tonë politike: të çrrënjosim krimin dhe korrupsionin, të çlirojmë ekonominë nga oligarkët që pamundësojnë zhvillimin ekonomik. Duke iu rikthyer shqiptarëve shpresën, duke rikthyer votën e lirë dhe të

ndershme. PD-ja do të futet në zgjedhje vetëm kur të garantohen kushtet për zgjedhje të lira dhe të ndershme", u shpreh Basha pas mbledhjes së Këshillit Kombëtar të PD-së. Sipas tij, largimi i kryeministrit Edi Rama është kusht i panegociueshëm për opozitën për nisjen e dialogut politik në vend. "Largimi i Ramës është kusht i parë dhe i panegociueshëm për nisjen e dialogut politik. Pa largimin e Ramës nuk ka dialog, pa largimin e Edi Ramës do të vazhdojë përballja në të gjitha format", tha Basha. Ai bëri të qartë se Partia Demokratike do të pamundësojë çdo krim tjetër elektorale si ai i vitit 2017, por pyetjes së gazetarëve lidhur me mënyrën që do ta arrijë diçka të tillë, ai tha se do të ketë kohë për shpallje të planit opozitar në javët në vazhdim. "Misioni ynë është i qartë. Këshilli Kombëtar ka sanksionuar hapat për betejën tonë politike që ka objektiva të qarta, të çrrënjosim krimin, të çrrënjosim korrupsionin. PD zotohet të pamundësojë çdo krim tjetër elektorale. Beteja për votën e lirë është betejë për çdo shqiptar", tha Basha. Kreu i PD-së konfirmoi se protestat do të vazhdojnë, ndërkohë që burime brenda mbledhjes bëjnë me dije se opozita e bashkuar do të organizojnë protestën e radhës më 11 maj.



Kryetari i PD-së, Lulzim Basha

AFATET

Z.Basha deklaroi: "Largimi i Ramës është kusht i parë dhe i panegociueshëm për nisjen e dialogut politik me PS, dialog i cili duhet të çojë në një qeveri transitore me mandat për të përgatitur zgjedhje të lira dhe të ndershme". Data 21 prill është afati për regjistrimin e partive politike dhe 1 maji është afati i fundit për koalicionet në zgjedhje, ndërsa 13 maji për regjistrimin e kandidatëve për kryetar bashkie dhe këshillat bashkiakë.

Zgjedhjet e lira, LSI mandaton Kryemadhin për marrëveshjen me PD-në

Kryesia e LSI-së vendosi dje të mandatohet kryetaren Monika Kryemadhin dhe Endri Braimllarin që të finalizojnë marrëveshjen e bashkëpunimit me PD-në dhe të gjitha partitë e frontit opozitar për garantimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, përfshirë këtu edhe detyrat e qeverisë transitore. Ky qe vendimi që u mor nga kryesia e kësaj partie, sipas një deklaratë që dha zëvendëskryetari i LSI-së, Luan Rama. "Kryesia e LSI-së - tha Rama - e mbledhur në mënyrë të posaçme për të analizuar situatën politike dhe zhvillimet e pritshme në vend, përkundrejt farsës dhe butaforisë së shëmtuar që ofron Kuvendi i votave të vjedhura nga bandat kriminale, konkludon se situata politike vjen gjithnjë duke u rënduar dhe se kriza politike vazhdon të jetë gjithnjë e më rëndë. Shqipëria është një shtet i kapur, një shtet i kapur nga strukturat kriminale që kanë imponuar vullnetin e tyre në zgjedhjet që kanë prodhuar maxhorancën, e cila është në shërbim të krimit dhe mbi bazën e këtij realiteti, aksioni politik i LSI-së i inkudruar në tërësinë e veprimtimit politik dhe qytetar të opozitës do të vazhdojë me vendosmëri për të mos lejuar që në këtë vend të ketë më zgjedhje farsë, për të mos lejuar që në këtë vend të ketë më zgjedhje që komandohen dhe blihen nga grupet kriminale, për të zgjedhur pushtetin dhe qeverinë që u shërben atyre", tha zyrtari i LSI-së.



PROTESTA

Opozita e bashkuar do të organizojnë protestën e radhës më 11 maj. Deri më tani, opozita ka realizuar 9 protesta, tri prej të cilave konsiderohen kombëtare dhe i tillë do të jetë edhe ajo e 11 majit. Gjithashtu, opozita ka realizuar edhe 7 protesta më të vogla përpara parlamentit në rreth dy muaj që kurse vendosi të digjte mandatet e deputetëve në parlament.

OSBE, 272 vëzhgues për zgjedhjet në Shqipëri

Raporti i OSBE/ODIHR: Klima e polarizuar mund të dëmtojë zgjedhjet

Në një raport të OSBE/ODIHR për vlerësimin e nevojave për zgjedhjet vendore të 30 qershorit theksohet se në prag të këtij procesi, në vend ka një shkallë të lartë të polarizimit dhe mosbesimit midis partive politike dhe politizimit të institucioneve. Kjo sipas raportit, mund të ndikojë negativisht në procesin zgjedhor. Duke marrë parasysh këto aspekte dhe mungesën e përmbljes së shumë rekomandimeve të mëparshme, ODIHR vlerëson se aktiviteti vëzhgues në këto zgjedhje është thelbësor. OSBE/ODIHR do të kërkojë dërgimin e 22 vëzhguesve afatgjatë dhe 250 vëzhguesve afatshkurtër për të ndjekur procesin



zgjedhor: "Përfaqësuesit e institucioneve shtetërore njoftuan se do të merrten të gjitha masat për të siguruar një proces zgjedhor transparent dhe për të pranuar rekomandime e vëzhguesve të OSBE/ODIHR", thuhet në raport.

Raporti vëren si shqetësim serioz edhe faktin se opozita ka refuzuar të emërojë kandidatët e saj në KQZ dhe KZAZ, duke sjellë çekuilibrim politik të tyre. Kjo, sipas raportit, ka ndikuar prej kohësh në besueshmërinë e institucioneve të menaxhimit të zgjedhjeve, për shkak të perceptimit të politizimit të tyre. Në një raport paraprak të publikuar një ditë më parë, OSBE-ja e vë theksin të klima e polarizuar politike që mund të dëmtojë procesin. "Ka një shkallë të lartë të polarizimit dhe mosbesimit midis partive politike dhe politizimit të institucioneve, që mund të ndikojë negativisht në zhvillimin e zgjedhjeve".

SHOQËRIA PËRMBARIMORE GJYQËSORE "3H" SH.p.k
 Rr. "Tish Daria", Kompleksi Kika 2, Kulla 5, Kt. 1, Tiranë
 Web: www.3h.ai; Email: shqgj_3h@yahoo.com; cel:9920909711

Njofton shpalljen e ankandit nga dt.16.04.2019 deri ne dt. 24.04.2019 per: sendin e luajtshem- automjetin terheqes Renault me Targa AA 245 OE, modeli Magnum 480 me cmin fillestar 751,800.00 Leke automjetin gjysem rrimorq marka Fruehauf TD 35, me Targa AER 831 me cmin fillestar 98,800.00 Leke ne pronesi te Subjektit Klodian Xhani PF me NIPT L02025004L
Ankandi zhvillohet ne zyrën permbarimore ne daten 24.04.2019 dhe mbyllet me orarin zyrtar 16.00

Dëshmia e shefit të Antidrogës, Ylli Bici: Në "Audi" nuk ishte Suel Çela

Klodiana Lala

TIRANË

Në procesin gjyqësor ndaj biznesmenit Suel Çela dhe miqve të tij, Enea Bekteshi e Kelmend Xhaferri, u dëgjuan rrëfimet e zyrtarëve të lartë të policisë së Elbasanit, lidhur me incidentin e ndodhur në hyrje të tregut agro-ushqimor mbrëmjen e 18 shtatorit të 2017. Ervin Ballaci, shefi i sektorit kundër krimeve të rënda në policinë lokale shpëgoi në Gjykatën për Krime të Rënda se ishin përfshirë në një aksion kundër makinave të vjedhura dhe të trafikuar.

DËSHMIA E ERVIN BALLACIT

"Por njëkohësisht, - theksoi ai - mëngjesin e asaj dite kishin marrë një denoncim nga një person, i cili pretendonte se ishte kërcënuar me vdekje brenda tunelit të rrugës Tiranë-Elbasan e për këtë ishin vënë në ndjekje të dy automjeteve tip 'Range Rover' dhe 'Audi'". "Sapo e konstataam mjetin 'Range Rover', - tha zyrtari i policisë, - e ndoqëm dhe i bëmë shenjë të ndalonte përpara tregut, për shkak se zona ishte e ndriçuar".

"Drejtuasi i mjetit ishte pajisur me një radiomarrës, të cilën tentoi t'ia jepte rojës së biznesit, - tha Ballaci, - e në këtë moment, nëndrejtori Gjergj Oshafi urdhëroi ta shoqëronim në komisariat".

"Kërkuam ndihmën e patrullës dhe po largoheshim, - tha shefi i sektorit kundër krimeve të rënda, kur një punonjës policie lajmëroi në radio se po vinte një makinë tip 'Audi' dhe zëri i tij ishte i shqetësuar. Ai na lajmëroi të kishim kujdes për jetën. 'Audi' goditi makinën, ku unë ndodhesha bashkë me nëndrejtorin Gjergj Oshafi dhe një oficer tjetër. Mjeti u largua me shpejtësi brenda ambienteve të tregut dhe në pak sekonda porta u mbyll, besoj përmes një pulsi në distancë", - dëshmoi Ballaci.

"Ne u gjendëm të papërgatitur për të ndërhyrë, pasi u tronditëm nga ngjarja, - theksoi Ballaci - por edhe sepse prisnin urdhra nga lart". "Dyshimet tona ishin se personat në fjalë kishin të shkuar kriminale, në fushën e trafikut të drogës dhe vrasjeve, por nuk mund të jap më shumë detaje, pasi janë informacione policore", rrëfeu më tej ai. Ervin Ballaci i tha trupës gjyqësore se kishin kërkuar ndihmën e Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë, porse ata kishin refuzuar të ndërhynin, ndaj në të tilla kushte u detyruan të prisnin ardhjen e forcave RENE nga Tirana. "Ne bëmë rrethimin e zonës dhe

Sulmi mbi policinë në Elbasan, Ervin Ballaci: Në treg ka tunele të nëndheshme me dyer të fortifikuara

Shefi i sektorit kundër krimeve: Dyshoj se prej andej u larguan personat që goditën mjetin e nëndrejtorit



Sulmi mbi policinë në Elbasan

kur mbërritën forcat speciale erdhi edhe pronari i tregut Petrit Çela dhe hapi derën", tregoi ai. "Në brendësi të biznesit - tha oficeri i Krimeve - kam konstatuar

se kishte tunele të nëndheshme me dyer të fortifikuara, prej nga dyshoj se janë larguar personat që goditën mjetin e nëndrejtorit".

DËSHMIA E YLLI BICIT

Më herët para gjykatës dëshmoi Ylli Bici, aktualisht shefi i sektorit antidrogë në Elbasan. Ai tha se mbërriti në

SI E GODITI "AUDI" MAKINËN E POLICISË

"Kërkuam ndihmën e patrullës dhe po largoheshim, - tha shefi i sektorit kundër krimeve të rënda, kur një punonjës policie lajmëroi në radio se po vinte një makinë tip 'Audi' dhe zëri i tij ishte i shqetësuar. Ai na lajmëroi të kishim kujdes për jetën. 'Audi' goditi makinën ku unë ndodhesha bashkë me nëndrejtorin Gjergj Oshafi dhe një oficer tjetër. Mjeti u largua me shpejtësi brenda ambienteve të tregut dhe në pak sekonda porta u mbyll, besoj përmes një pulsi në distancë", - dëshmoi Ballaci.

derën e tregut pas njoftimit në radio që bëri nëndrejtori, i cili u kërkoj shoqërimin në komisariat të një personi, por në këto momente një automjet 'Audi' goditi makinën e Gjergj Oshafit. Bici sqaroi se mjetin luksoz 'Audi' e drejton të një person jo më shumë se 35 vjeç, i shëndoshë dhe që mbante kapele në kokë, të cilin tha se nuk e identifikonte dot. Sikurse kolegu i tij, Bal-

laci, edhe Bici tha se policia ishte e pa përgatitur për të reaguar, pasi jo vetëm u tronditën nga ngjarja, por nga brenda tregut dëgjuan të shëna armësh. Biznesmeni Suel Çela, i cili ndodhet në arrati dhe dy të pandehurit e tjerë, po gjykojnë për akuzat e vrasjes ndaj punonjësit të policisë, kryer të bashkëpunim mbetur në tentativë dhe armëmbajtjes pa leje.

Banorët shpëtuan të miturën dhe bënë për spital 50-vjeçar

Tentoi të përdhunonte 13-vjeçaren nga Hungaria, në pranga turisti kanadez

DURRËS - Një turist kanadez është bërë për spital nga banorët e plazhit të Durrësit, pasi ka tentuar të përdhunojë një vajzë të mitur. Bëhet fjalë për 50-vjeçarin Rober Hederson, ndaj të cilit, policia e qytetit bregdetar ka prerë fletë-arrestin. Mësohet se ngjarja ka ndodhur mesditën e së mërkurës në lagjen nr.13 të këtij qyteti. Sipas burimeve nga policia lokale, Hederson ka tentuar të përdhunojë një turistë 13-vjeçare nga Hungaria, e cila kishte ardhur për pushim bashkë me familjen e saj në Durrës. Po të njëjtat burime u shprehën se kanadezi ka tentuar që ta çojë me forcë të miturën në apartamentin që kishte marrë me qira në zonën pranë bregdetit. Kjo ngjarje me pasojë të rënda për vajzën është parandaluar nga banorët të zonës, të

cilët kanë ndërhyrë në kohë. Ndërkaq, mësohet se përplekja e 50-vjeçarit për të përdhunuar turistin ka zgjatuar vetëm disa çaste, pasi ka qenë vetë 13-vjeçarja që ka kërkuar ndihmë në momentin që kuptoi se kishte qëllime të tjera.

ARRESTIMI

Sipas policisë së Durrësit, Rober Hederson u arrestua me akuzën tentativë përdhunimi të një shtetase hungareze e moshës 13 vjeçe. Fatmirësisht, 50-vjeçari nuk arriti që të realizonte objektivin tij, pasi u pikas nga banorët e zonës. Madje, banorët e kanë goditur e rrahur barbarisht atë, duke e bërë për spital. Hederson qëndroi rreth 12 orë në urgjencën e spitalit të Durrësit ku mori ndihmë mjekësore, pasi kishte hematomë në pjesë të ndryshme të trupit dhe në fytyrë. Burimet e mësipërme sqaru-

an se kanadezi i kishte kërkuar vajzës t'i tregonte se ku ndodhej vendi që ai do të shkonte, duke qenë se ajo dinte të fliste anglisht. Pasi qëndruan për disa minuta bashkë, ai i kishte kërkuar ta shoqëronte deri tek pallati, sepse druante se mund të humbte rrugën. Me shumë mirësjellje, vajza 13-vjeçare e ka shoqëruar deri pranë pallatit në plazhin e Durrësit. Në momentin që i janë afruar pallatit (ishte në një zonë disi të fshehur), Rober Hederson i ka kërkuar ta shoqëronte deri tek apartamenti. E ndërsa vajza ka refuzuar të ngjete bashkë me 50-vjeçarin në apartament, ai e ka kapur për dorë duke përdorur forcë për ta futur në hyrjen e pallatit. Në këtë moment, e mitura ka bërë thirrje duke kërkuar ndihmë. Për fatin e saj të mirë, aty pranë ndodheshin disa banorë të zonës,



Kanadezi në spitalin e Durrësit

të cilët janë afruar për t'i dhënë ndihmë. Por jo vetëm kaq, banorët e kanë rrahur turistin kanadez dhe kanë njoftuar policinë, e cila ka mbërritur shpejt në vendngjarje. Gjatë marrjes në pyetje nga oficerët e Policisë Gjyqësore, turisti kanadez nuk e ka pranuar akuzën. Në dëshminë e tij, Hederson ka thënë se veprimi i tij është keqkuptuar nga vajza dhe se nuk ka tentuar të abuzojë seksualisht me të. Ndërkaq, policia e Durrësit ka vënë në dijeni ambasadën kanadeze, me qëllim marrjen e informacioneve rreth personalitetit dhe se shkruar të 50-vjeçarit, detaje që do të ndihmojnë në hetimin e rrethanave të ngjarjes.

DËSHMIA E TURISTIT

"Nuk është aspak e vërtetë që tentova të përdhunoja një vajzë të mitur. Absolutisht nuk kisha

këtë qëllim. Unë i kërkoja të më shoqëronte dhe në momentin që mbërrita në destinacion, thjesht e përqafova në shenjë falënderimi. Ky gjest u keqkuptua nga vajza. Ajo bërtiti dhe kërkoj ndihmë. Kjo është e gjitha. Në momentin që vajza bërtiti, u afruan disa qytetarë, të cilët edhe më goditën", është shprehur turisti kanadez. Ndërsa vajza ka një version tjetër. Në prani të psikologut, ajo ka pohuar ndër të tjera se në momentin që kishin mbërritur pranë pallatit, në një rrugicë të zonës së plazhit, 50-vjeçari i ka kërkuar ta shoqëronte deri tek apartamenti. "Unë refuzova ta shoqëroja, ndërsa ai më kapi prej dorë duke tentuar të më fuste forcërisht në hyrje të pallatit. U frikësova, bërtita dhe kërkoja ndihmë", ka deklaruar 13-vjeçarja.

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Përbarimorë "E.G Bailiff Service" me Përbarues Gjyqësor Enuar Merko me adresë, Rruga Ibrahim Rugova", Pallati 64, Hyrja 8, Apartamenti 1, Tiranë, njofton se më datë 17.05.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi III - rë për shiten e pasurisë së palajshme, Apartamenti me numër pasurie Nu/5254/ND+1-2, Zona Kadasirale 3250, Vokumi 20, Faqe 118, me sipërfaqe 137 m², ndodhur në adresën: Bulevardi "Zhan D'Ark", Tiranë, pronësi: Z.Bujar Musa Kajazi, me vlerë filltare në ankand 62.234.4 (Gjasthërdhjetë e dy mijë e dyqind e nëntëdhjetë e katër mijë pikë katër) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, + 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com;

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Përbarimorë "E.G Bailiff Service" me Përbarues Gjyqësor Enuar Merko me adresë, Rruga Ibrahim Rugova", Pallati 64, Hyrja 8, Apartamenti 1, Tiranë, njofton se më datë 03.05.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi II - rë për shiten e pasurisë së palajshme, Trulli me sipërfaqe totale 3104 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Durrës, me Nr. pasurie 16/131, Volumi 11, Faqe 10, Zona Kadasirale 8516, në pronësi të Shoqërisë "ADRIATIKA BETON" sh.p.k, me vlerë filltare në ankand 322.816 (Treqind e njëzet e dy mijë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë) Euro. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, + 355 4 22 31 888. email enuar.merko

TIRANË - Admir Murataj dyshohet se ka bashkëpunuar me ish-komando të ushtrisë për të realizuar grabitjen e parave në pistën e Rinasit mesditën e 9 prillit. Hetuesit, pasi kanë analizuar pamjet filmike dhe kanë vëzhguar lëvizjet e personave që nën kërcënimin e armëve rrëmbyen paratë, kanë dyshime se një prej tyre është ish-komando. Bëhet fjalë për grabitësin që qëndron në krah të Admir Muratajt. Ekspertët i kanë shtuar dy-



Grabitja në Rinas

Vetëm 2 prej grabitësve qëlluan ndaj policisë

Një ish-komando në grabitjen e Rinasit?

shimet mbi ish-komandoninur nga lëvizjet e tij. Ai mban pozicion trupor dhe armën në mënyrë të ngjashme me ato të forcave speciale të ushtrisë. Nuk është e qartë nëse komandoja është përfshirë në shkëmbimin e zjarrit me Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë, ku mbeti i vrarë Murataj. Burime nga grupi hetimor i

thënë televizionit Klan se vetëm 2 nga 5 grabitësit kanë përdorur armët. Në vendin e ngjarjes janë gjetur 10 gëzhoja kallashnikov, të qëlluara nga dy armë të ndryshme. Ndërsa Admir Murataj rezultoi të jetë qëlluar vetëm me 1 plumb, i cili i ka hyrë në syrin e majtë dhe ka dalë pas kokës. Hetimet vazhdojnë, ndërsa

Prokuroria e Krimeve të Rënda përmes një shkrese, u ka kërkuar tri bankave të nivelit të dytë të saktësojnë shumën e parave që u grabit. Prej kësaj ngjarje, bankat dhe kompanitë ajrore kanë refuzuar të bëjnë dërgesa të tjera të parave jashtë vendit, për shkak se e konsiderojnë Rinasin të pasigurt.

Kushtet e vështira, 3 fëmijë dhe 5 gra nga Kosova kanë vdekur

"Familjet e shqiptarëve të ISIS në Siri, rruga e gjatë e kthimit për në shtëpi"

Në kampin Al Hol, janë gjithsej 108 persona nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut

Të paktën 85 fëmijë që kanë lindur në Siri nga gra me shtetësi nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut, ndodhen në një kamp të drejtuar nga Kurdët. Kështu e nis "Balkan Insight" artikullin me titull "Familjet e luftëtarëve shqiptarë të ISIS përballesh me rrugën e gjatë të kthimit në shtëpi", referuar një investigimi të BIRN.

Lavdrim Muhaxheri, një luftëtar i njohur i Shtetit Islamik nga Kosova, i cili e deklaroi veten si komandant i shqiptarëve që luftonin për grupin militant në Siri dhe Irak, u shpall i vdekur në 2017-ën.

Dy vjet më vonë, fëmijët e tij në Siri fryt i marrëdhënies me një grua shqiptare nga Tirana po jetojnë në një kamp të drejtuar nga kurdët, sipas gjetjeve të një hetimi të BIRN.

Të dy fëmijët janë në mesin e të paktën 85 fëmijëve në kampin 'Al Hol' të grave me etni nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut.

Të paktën 27 kanë lindur në Siri, ndërsa shumë prej tyre e kanë humbur një prej prindërve. Tre fëmijë të lindur nga një grua kosovare raportohet se kanë vdekur bashkë me nënën e tyre, ndërsa katër gra kosovare kanë vdekur, sipas listave të siguruar nga BIRN.

Aktualisht, një grup prej 108 gra dhe fëmijë nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut duan të kthehen në Ballkan dhe të largohen nga kampi Al Hol.

"Rruga e shtëpisë për këto gra dhe fëmijë duket më e ndërlikuar nga sa mund të imagjinohet. Autoritetet në tre vendet e Ballkanit janë ngurrues për t'i parë ata të kthehen dhe deri tani nuk kanë një plan se si mund të riatdhesohen", - thuhet në artikull. Kampi Al Hol është nguritur në disa tenda në provincën siriane të El-Hasakah. Sipas Kombeve të Bashkuara, aktualisht në të janë rreth 73,000 njerëz. Sipas Zyrës së OKB-së për Koordinimin e Çështjeve Humanitare, rreth 65 për qind e njerëzve në kamp janë fëmijë nën moshën 18 vjeç dhe rreth 27% janë gra. Refugjatët e zhvendosur brenda vendit dhe refugjatët irakianë përbëjnë shumicën, por rreth 15% janë të ashtuquajturat shtetas të vendeve të treta.



Foto ilustruese

KAMPI AL HOL

Ky kamp është ngritur në disa tenda në provincën siriane të El-Hasakah. Sipas Kombeve të Bashkuara, aktualisht në të janë rreth 73,000 njerëz. Sipas Zyrës së OKB-së për Koordinimin e Çështjeve Humanitare, rreth 65 për qind e njerëzve në kamp janë fëmijë nën moshën 18 vjeç dhe rreth 27% janë gra. Refugjatët e zhvendosur brenda vendit dhe refugjatët irakianë përbëjnë shumicën, por rreth 15% janë të ashtuquajturat shtetas të vendeve të treta.

Shumë nga gratë shqiptare dhe fëmijët e tyre janë të dëshpëruar dhe kërkojnë të kthehen shtëpi. "Ata na kanë nën mbikëqyrje dhe jemi të rrethuar nga tela dhe ushtarë", dëgjohej një fëmijë duke i treguar një të afërmi në Shqipëri, në një regjistrim audio të siguruar nga BIRN. "Nuk mund të flas shpesh, por, ju lutemi, flisni me shtetin tonë që të vijmë dhe të na marrin." Elodie Schindler, zëdhënëse për Evropën dhe Azinë Qendrore në Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, tha se gratë dhe fëmijët në kamp kërkonin mbrojtje të veçantë. Schindler tha se shumë fëmijë ishin pa shtetësi zyrtare, nuk kishin qasje

në shkollim dhe ishin të riskuar nga abuzimet dhe sëmundjet. "Këta fëmijë janë viktimë që nuk duhet të ndëshkohen për mëkatet e prindërve të tyre... Shumë prej tyre nuk kanë ushqim të mjaftueshëm. Ata duhet të trajtohen më mirë", - tha Schindler për BIRN. BIRN i kërkoi Ministrive të Brendshme të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut nëse ata kishin identifikuar dhe kontaktuar qytetarët e tyre në kampet. Ministria shqiptare nuk u përgjigj. Kosova nuk pranoi të komentojë, ndërsa Ministria e Brendshme e Maqedonisë Veriore tha se kishte identifikuar katër gra maqedonase dhe shtatë fëmijët e tyre. "Ata kanë vendosur kontakte me qëllim të marrjes së dokumenteve dhe lehtësimin e transportit nga Siria në Maqedoninë Veriore", tha një zëdhënësi i ministrit.

8

GRA E FËMIJË TË VDEKUR

Të paktën 27 kanë lindur në Siri, ndërsa shumë prej tyre e kanë humbur një prej prindërve. Tre fëmijë të lindur nga një grua kosovare raportohet se kanë vdekur bashkë me nënën e tyre, ndërsa katër gra kosovare kanë vdekur, sipas listave të siguruar nga BIRN. Aktualisht, një grup prej 108 gra dhe fëmijë nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut duan të kthehen në Ballkan dhe të largohen nga kampi Al Hol.

SHKURTE

Nuk justifikon pasurinë, KPA përjashton nga sistemi gjyqtarin, Astrit Faqolli

TIRANË - Komisioni i Posaçëm i Apelit ka shkarkuar në formë përfundimtare gjykatësin pranë Gjykatës në Rrethin Gjyqësor të Tiranës, Astrit Faqolli. Nga hetimet e kryera nga KPA-ja, rezultoi se subjekti vlerësues ka probleme me kriterin e pasurisë, ku të dhënat e deklaruar nuk përputhen me ato reale. Më parë, gjyqtari në fjalë u konfirmua në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, por ky vendim u apeluar nga Komisioneri Publik, veprim ky që solli më pas edhe përjashtimin e tij nga sistemi i drejtësisë. "Në vlerësimin e Komisionerit Publik, në rastin konkret, konfirmimi në detyrë i subjektit të rivlerësimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është bërë në interpretim të gabuar të ligjit dhe të provave të administruara gjatë hetimit administrativ", pohoi Komisioneri Publik.

I zhatën një shtetaseje rreth 40 mln lekë për legalizimin e banesës, kapen 2 mashtruesit

TIRANË - Dy persona janë arrestuar dje nga policia e Tiranës, pasi me anë të mashtrimit, i kanë marrë një shtetaseje një shumë në lekë dhe euro, për legalizimin e një ndërtimi pa leje dhe për njohjen e një sipërfaqjeje trualli. Burime zyrtare nga dikasteri i Rendit dhe bënë me dije se Seksioni për Hetimin e Krimit Ekonomik dhe Financiar në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në kuadër të operacionit policor të koduar "Impostors", ndaloi shtetasit B.P., 36 vjeç dhe O.S., 31 vjeç, të dy banues në kryeqytet. Mësohet se dy personat e mësipërm në bashkëpunim me njëri-tjetrin, me anë të mashtrimit, i kanë marrë një shtetaseje një shumë prej 27 780 euro dhe 985 000 lekë, për legalizimin e një ndërtimi pa leje dhe për njohjen e një sipërfaqjeje trualli. Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në ngarkim të shtetasve të mësipërm për veprën penale "Mashtrimi".

Shqipëria do të ketë një linjë direkte fluturimi me Riadin. Për këtë qëllim, Ministria e Infrastrukturas dhe Energjisë nënshkroi të enjten një memorandum bashkëpunimi me kompaninë saudite të fluturimeve "FLYNAS". Linja ajrore mendohet t'i shërbejë sidomos turizmit nga Arabia Saudite dhe vendet e Lindjes së Mesme, por edhe zhvillimit të marrëdhënieve ekonomike me rajonin në fjalë. Gjatë ceremonisë së nënshkrimit të



Ministria Belinda Balluku

Linjë ajrore me Riadin

Balluku: Do t'i shërbejë turizmit nga Lindja e Mesme

marrëveshjes, ministria Belinda Balluku tha se bashkëpunimi me "FLYNAS" shënon një hap të rëndësishëm në tërheqjen e kompanive të reja ajrore në Shqipëri. Ndërtimi dhe operimi i aeroporteve të rinj pritet të ndihmojë në rritjen e tregut.

Ministria Balluku tha se brenda dy viteve do të jetë gati aeroporti i Kukësit, ndërsa së shpejti do të hapet një konkurs ndërkombëtar për ndërtimin e aeroportit të Vlorës. "FLYNAS" është një nga kompanitë ajrore "low cost" më të rëndësishme në

Lindjen e Mesme. Ajo është themeluar në vitin 2007 dhe sipas informacionit në faqen zyrtare, kryen fluturime në 35 destinacione. Së fundmi "FLYNAS" ka porositur 120 avionë të rinj 'airbus', me një marrëveshje në vlerën e 8.6 miliardë dollarëve.

Raporti, rritja e çmimeve në mars u udhëhoq nga hotelet dhe restorantet

EUROSTAT, për Shqipërinë: U rritën ushqimet dhe qiraja

Indeksi i çmimeve të konsumit për mars 2019 është 1,4%

Rritet kostoja e jetesës për shqiptarët. Në muajin mars janë shtrënguar çmimet e ushqimeve dhe qiratë. Të dhënat janë pjesë e raportit të EUROSTAT, sipas të cilit mësohet se niveli i përgjithshëm i çmimeve i matur sipas metodës së EUROSTAT u rrit me ritme më të ulëta gjatë muajit mars 2019, duke ndjekur pak a shumë e ecurinë e të dhënave kombëtare për këtë tregues. Sipas matjeve të EUROSTAT, ndryshimi vjetor i matur nga Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit në muajin mars 2019 është 1.4%.

RRITJA

Rritja më e madhe e çmimeve, prej 3.6%, vërehet në grupin "Hotele, kafene dhe restorante", pasuar nga grupet "Ushqime dhe pije joalkoolike" me 2.6%, "Pije alkoolike dhe duhan" me 0.6%, "Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji" me 0.4%, "Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje" dhe "Mallra dhe shërbime të ndryshme" me 0.2% secili. "Veshje dhe këpucë" dhe "Shërbimi arsimor" me 0.1% secili. Nga ana tjetër, çmimet e grupit "Argëtim dhe kulturë" u ulën me 0.4%, pasuar nga grupet "Shëndeti" me 0.3%, ndërsa "Transporti" me 0.2%. Në muajin mars 2019, ndryshimi mujor i matur nga Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit është -0.5%. Ky ndryshim është ndikuar kryesisht nga ulja e çmimeve të grupit "Ushqime dhe pije joalkoolike" me 1.2%, pasuar nga grupet "Veshje dhe këpucë" me 0.5%, "Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji" me 0.4%, etj. Nga ana tjetër, çmimet e grupit "Transporti" u rritën me 0.3%, pasuar nga "Pije alkoolike dhe duhan", "Shëndeti" dhe "Argëtim dhe kulturë" me 0.1% secili.



INFLACIONI

Inflacioni i Eurozonës matet mbi bazën e treguesit të IHCK-së. Termi "i harmonizuar" nënvizon faktin që të gjitha vendet e BE-së zbatojnë të njëjtën metodologji në matjen e treguesit përkatës. Ndryshimet e kontributit nga një tregues në tjetrin lidhen me faktin se

kompozimi i peshave të mallrave brenda grupit "Ushqime dhe pije joalkoolike" është i ndryshëm nga një tregues në tjetrin. Kështu, brenda këtij grupi, nëngrupi "Fruta-Perime" ka një peshë më të madhe të shporta e IHCK-së (12.84% e shportës totale) sesa tek ajo e ICCK-së (8.44% e totalit). Për shkak të këtij ndryshimi, kontributi i këtij grupi mallrash të totali është i barabartë me 2.5 pikë përqindje në rastin e treguesit

IHCK dhe me 1.2 pikë përqindje në rastin e ICCK-së. Ndryshime të vogla në kontribute vihen re edhe në disa grupe të tjera, por jo në madhësinë e ndryshimit të rasti të mësipërm. Zërat e shportave përkatëse në rastin e Shqipërisë. ICCK-ja përmban 332 zëra, IHCK-ja përmban 331 zëra (qiraja e imputuar nuk është element i shportës). ICCK-ja mbulon vetëm shpenzimet familjare private shqiptare të kryera,

brenda territorit të vendit. Burimi kryesor i të dhënave për shpenzimet ("peshat") është Anketa e Buxhetit të Familjeve (ABF); IHCK-ja mbulon të gjitha shpenzimet e kryera brenda territorit të vendit nga familjet shqiptare, si dhe shpenzimet e vizitorëve rezidentë dhe jorezidentë. Burimi kryesor i të dhënave për shpenzimet ("peshat") janë llogaritë kombëtare "Shpenzimet Monetare të Konsumit Final të Familjeve (HFMC)".



SHKURTE

Rrjeti i ujësjellësit, ARRSH: Masa të menjëhershme për ta rikonstruktuar

Autoriteti Rrugor Shqiptar ka njoftuar se do të marrë masa të menjëhershme për rehabilitimin e rrugës pas investimit për ujësjellës-kanalizim. Pritet të nisë shumë shpejt investimin për rikonstrukcionin e rrjetit të ujësjellësit nga "Mulliri i bullgarit" deri në afërsi të Urës së Shijakut. ARRSH tha se është një investim me fonde të UKD me vlerë 64 milionë lekë, procedurë e cila është prokuruar dhe për një javë pritet të nis punimet. Gjithashtu, projekti parashikon zëvendësimin e linjës DN 400 mm, e cila është mjaft e amortizuar dhe në shumë pjesë është çarë, duke sjellë ndotje të ujit, si dhe dëmtime të aksit rrugor kombëtar, duke qenë se kjo linjë gjendet pikërisht poshtë rrugës në fjalë. ARRSH tha se gjatë punimeve do të shtrohet linja kryesore me tubacion 400 mm me gjatësi 2,7 km, rrjeti shpërndarës me gjatësi 6 km, si dhe do të ndërtohen 72 kaseta shpërndarëse për instalimin e matësve të ujit. Njoftimi tha se rreth 2 600 banorë përfitojnë nga ky investim në Bashkinë Shijak dhe Bashkinë Durrës. ARRSH tha se pas kryerjes së punimeve për projektin e Ujësjellës-Kanalizime Durrës, është planifikuar që Autoriteti Rrugor Shqiptar të ndërhyjë për rehabilitimin, mirëmbajtjen dhe asfaltimin e rrugës në fjalë, e cila deri më sot për shkak të mungesës së investimeve në rrjetin e infrastrukturës së kanalizimeve dhe ndërhyrjes së paautorizuar të qytetarëve dhe bizneseve ka pësuar dëmtime të rënda.

AMF dhe DPPPP, trajnim për subjektet që mbikëqyrin

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare njoftoi se në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP) organizoi ditën e djeshme një trajnim për subjektet që mbikëqyrin nga Autoriteti. Sipas AMF-së, pjesëmarrës në trajnim ishin përfaqësues nga tregjet financiare jo bankare si agjentë, brokera e shtëpi brokerimi, shoqëri të sigurimit të jetës, përfaqësues nga shoqëritë administrative të fondeve të pensioneve etj.. AMF tha se ky trajnim është në kuadër të adresimit të rekomandimeve të Komitetit MONEYVAL të Këshillit të Evropës, të cilat janë shoqëruar me ndryshime të akteve rregullative në vend. Sipas njoftimit, drejtues dhe ekspertë nga AMF dhe DPPPP prezantuan ndryshimet ligjore, aktet nënligjore dhe udhëzimet e lidhura me to.

Takimi me grupet e interesit/ Qeveria tërhiqet nga ndryshimi i taksës, rishikim brenda muajit

Taksa e plastikës, Shalsi e Denaj: Gabuam

Ministri: Sektori ka evazion, u shkaktua anomali në treg

Qeveria tërhiqet nga vendosja e taksës së plastikës, e cila është pasuar me efekte negative të prodhuesit shqiptarë. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Anila Denaj dhe ministri për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Eduard Shalsi kanë zhvilluar dje një dëgjësë me grupet e interesit, ku pranuan se vendosja e taksës ishte e gabuar, ndërsa kanë premtuar se brenda muajit do të dalin me nivele të rishikuara, por pa dhënë propozime konkrete.

INTERPELANCA

Përfaqësues të biznesit patën një interpellancë me ministrin e Financave dhe Ekonomisë, Anila Denaj dhe ministren e Mbrojtjes së Sipërmarrjes, Eduard Shalsin, ministrin për Sipërmarrjen për të diskutuar për ndryshimet në paketën fiskale mbi taksimin e produkteve plastike dhe lëndëve të para që importohen për prodhimin e tyre. Sipas ministres së Financave dhe Ekonomisë, ligji pati qëllim kryesor rishikimin e taksës së plastikës për ndikimin e drejtpërdrejtë që pati kjo taksë në kostot e biznesit. "Ulja e taksës nga 100 lekë në 35 lekë pritej të kishte një efekt pozitiv të biznesit, por edhe të konsumatori final nëpërmjet uljes së çmimeve. Në paketën fiskale u konsoliduan edhe disa elemente, për të cilat ju thoni se ju kanë rënduar. Në fakt, problematikat e hasura gjatë vitit nuk lidhen vetëm me taksën, por edhe me administrimin në sistem. Taksa 25 lekë për importet e lëndëve primare të plastikës u konsiderua një taksë e shtuar për prodhimin vendës, - tha Anila Denaj, ministre e Financave dhe Ekonomisë. "Disa nga produktet u ndëshkën me rëndimin e taksës në të gjithë zinxhirin e tyre, pasi udhëzimet nuk erdhën në kohë. Udhëzimet dolën në shkurt dhe kjo krijoi një shqetësim. Me publikimin e udhëzimit, mendoj se kemi adresuar 80% të shqetësimeve që keni pasur", - tha ministria. Vullnet Haka, përfaqësues i sektorit të plastikës, në emër të Bashkimit të Prodhuesve tha se janë rreth katër muaj që ka hyrë në fuqi taksa 35 lekë për ambalazhet e plastikës dhe 25 lekë për kg për importet e lëndëve të para. "Ky vendim ka vënë në veshitërisë biznesin", - tha Haka. Sipas Hakës, taksa preku shumë sektorë të tjerë, si ndërtimi, prodhimi i bojërave, sfungjer-



DEKLARATAT



VULLNET HAKA

"Përfaqësuesit e industrisë dhanë argumentet kundër taksës. Në këto kushte, vetëm duke iu referuar taksës për lëndën e parë, kemi taksuar lëndën e parë me 20%, ndërsa për produktet e gatshme i kemi taksuar në vlerë rreth 15%. Kjo është një taksë diskriminuese për prodhimin vendës", - tha Vullnet Haka, përfaqësues i biznesit.



EDUARD SHALSI

"Në morinë e të dhënave që dispononim, 'output'-i nuk përputhej me 'input'-in. Sasia e granulatit nuk përputhej me 'output'-in e tij, pra kishte evazion. Spektri i produkteve ishte shumë më i madh nga ai që kishim diskutuar. Shkaktoi anomali në treg".



it dhe të prodhimit të materialeve të ndërtimit. "Në këto kushte, vetëm duke iu referuar taksës për lëndën e parë, kemi taksuar lëndën e parë me 20%, ndërsa për produk-

tet e gatshme e kemi taksuar në vlerë rreth 15%. Kjo është një taksë diskriminuese për prodhimin vendës", - shpjegoi ai. Eduard Shalsi, ministër i Sipërmarrjes, tha se taksa e ambalazhit që nga 100 lekë u vendos 35 lekë ka qenë propozim i biznesit. "Në morinë e të dhënave që dispononim, 'output'-ti nuk përputhej me 'input'-in. Sasia e granulatit nuk përputhej me 'output'-in e tij,

Ministria

ANILA DENAJ

"Ulja e taksës nga 100 lekë në 35 lekë pritej të kishte një efekt pozitiv të biznesit, por edhe të konsumatori final nëpërmjet uljes së çmimeve. Në paketën fiskale u konsoliduan edhe disa elemente, për të cilat ju thoni se ju kanë rënduar".

pra kishte evazion. Spektri i produkteve ishte shumë më i madh nga ai që kishim diskutuar. Shkaktoi anomali në treg. Udhëzimi i muajit shkurt synoi që të korrigjonte atë pjesë nga ndryshimet e taksës. Referenca ishte kodi 39. Në këtë sektor kemi një masë të madhe informaliteti", - tha ministri Shalsi. Shalsi tha se taksa për 25 lekë për kg për importet e lëndëve të para,



ANILA DENAJ

pjesë e Kodit 39, është duke u shqyrtuar me shumë kujdes dhe përgjegjësi dhe se do të ndryshojnë masën. "Ne jemi të bindur që duhet ulur. Fundi i muajit do të na gjëjë me një propozim konkret", - tha Shalsi. Neritani Male, i cili operon në sektorin e termoizolimit shpjegon se është prekur nga taksa, duke sjellë një rritje të çmimeve për produktet e termoizolimit

me 15%, duke i bërë joatraktive. Kjo taksë sipas, Males po aplikohet mbi një produkt miqësor me mjedisin. Shalsi argumentoi se rasti i biznesit të zotit Male, apo ai i prodhimit të bojërave ishin kategori që nuk ishin parashikuar. "Kemi ngritur një grup për një zgjidhje finale të problemit, ndryshime ligjore. Ka një shqetësim që duhet ta marrim në konsideratë, zbatimi i udhëzimit nga Doganat dhe Tatimet. Çdo udhëzim merr dhe fazën e axhustimit. Tashmë jemi në fazën e axhustimit institucional. Disa prej drejtorëve po azhurnohen me vëshitërisë", - shpjegoi Shalsi. Vullnet Haka, përfaqësues nga industria, në fund të takimit parashitroi edhe një herë kërkesat e industrisë: "Duhet të rikthehet siguria të sipërmarrjes, kërkojmë që të shkojë 5 lekë për kg, të ketë përcaktim të përjashtimeve të qarta në ligj për materialet që shërbejnë për sektorin e ndërtimit. Këto janë kërkesat finale".



Rrëshqitjet në aksin Memaliaj-Tepelenë

ARRSH: Nis puna për rehabilitimin, ndërhyrjet që do të kryhen

Autoriteti Rrugor Shqiptar bëri të ditur dje se ka nisur puna të rrëshqitja në aksin Degëzim Memaliaj-Tepelenë. Sipas ARRSH-së, nga inspektimet rutinë të kontraktorit është konstatuar rrëshqitja e murit për shkak të mosfunksionimit të sistemit të drenazhit e shkarkimit e pakontrolluar të ujërave sipërfaqësore. Projekti përfshin një sërë ndërhyrjesh me qëllim rritjen e sigurisë për përdoruesit e rrugës. "Për të mos lejuar dëmtimin e mëtejshëm të trupit të rrugës, u përgatit një projekt për stabilizimin e rrëshqitjes me gjeogrid. Ky projekt parashikon një strukturë Gjeosintetike (Terramesh) me gjatësi 36 m dhe lartësi 6-9 m përgjatë lumit Vjosë. Më tej do të rehabilitohet sistemi i drenazhit të ujërave sipërfaqësore. Ndërkohë, te portali shkarkues do të zbatohet elementi i shuarjes, në mënyrë që të parandalohet fenomeni i mëtejshëm i erozionit", thuhet në njoftimin e ARRSH-së.

Njoftim shitje me ankand

Shoqëria përmbarimore "AA Bailiff" shpk, zhvillon ankandin e III-të, për shitjen e pasurisë së paluajtshme, Trullit 310 m² dhe ndërtesë 96 m², me nr. pasurive 170/14, Vol. 8, Fq. 154, ZK. 3852, në pronësi të Ruzhdit Demir Tropolini e regjistruar ne ZVRRP Durres
 Çmimi i ankandit të trete është EUR 21,600 (njëzetë e një mijë e gjashtëqind euro)
 Ankandi zhvillohet dt. 10/05/2019, ora 16.00 në adresën Rruga e Kavajës, Ndërtesa 27, Hyrja 1, Kati i III-të, Tiranë. Kontakt: cel. 0688012846, ose në adresën e email: aabailiff@gmail.com.

Instituti i Vjenës: Rritja rezulton 4 herë më e madhe se inflacioni

Shqipëria është cilësuar si vendi me rritjen më të madhe të pagave në rajon. Rritja rezulton të jetë katër herë më e madhe se inflacioni. Të dhënat janë bërë publike nga Instituti i Vjenës për Studime Ekonomike, i cili ka publikuar një studim në lidhje me ecurinë e çmimeve të konsumit në vendet e Europës Qendrore dhe Juglindore. Inflacioni krahasohet edhe me indikator të tjerë, siç janë pagat. Nga të dhënat rezultojnë se Shqipëria është një ndër vendet që ka njohur rritjen më të madhe nominale të pagave, bindshëm përtej normës së inflacionit. Sa u përket pagave, me një rritje pranë 10%, rezultojnë se Shqipëria është e 8-ta në rajon në terma rritjesh. Për Shqipërinë, pagat janë rritur me të paktën 7 pikë përqindje përtej hapit të rritjes së çmimeve të konsumit. Ndërsa vendet e Ballkanit Perëndimor, Shqipëria rezulton të jetë e para, si për rritjen e pagave, ashtu edhe për diferencën mes kësaj indikatorit dhe atij të inflacionit. Sa i përket normës së ulët të inflacionit në të gjithë Europën Qendrore dhe Juglindore, Instituti i Vjenës jep disa arsye. Një ndër to u referohet çmimeve mjaft të ulëta të ushqimeve në nivel global. Që prej vitit 2011, indeksi global i çmimeve të ushqimit ka rënë me 27%. Një arsye tjetër vlerësohet të jenë normat e larta të kursimit të familjeve, apo edhe ecuria e çmimeve në Eurozonë, si dhe integrimi më i madh i rajonit. Tjetër arsye vlerësohet edhe kursi i këmbimit, duke qenë se për pjesën më të madhe të vendeve të rajonit, mallrat e konsumit prodhohen jashtë.

NJOFTIM ANKANDI

1. Shoqëria e Përmbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k njofton Shpalljen e Ankandit të II (Dyë), për shitjen e pasurisë së paluajtshme: Njësi, me sip. 142 m², Zona Kadastrale: 2640, Numri i Pasurisë: 496/380+3-N2, Vol. 52, Fq. 239, ndodhur në Linzë Dajç, Tiranë, në pronësi të: Shoqërisë "AGL" shpk identifikuar me NIFIT 171702004M. Ankandi i pasurisë filton me çmimin fillestar në vlerën 4,962,048 (katër milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyzet e tetë) LEKË.
 Ankandi do të zhvillohet më datë 23.04.2019, ora 16:00, pranë zyrës së Shoqërisë së Përmbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k, në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr.telefon 042320227, email: elvinth@hotmail.com.

Lista me përfituesit, nis procesi për dëmshtëpërblimin e ish-të dënuarve politikë

Trashëgimtarët e ish-të dënuarve politikë për fitojnë pagesat për kështin e tretë të kompensimit. Janë në total 500 përfitues, të cilët duhet të plotësojnë dokumentet për të marrë kështin e tretë. "Gazeta Shqiptare" publikon listë me trashëgimtarët, të cilëve u kërkohet të dorëzojnë në Drejtorinë e Përfitimeve certifikatë personale dhe numër të ri të llogarisë bankare. Pasi të plotësojnë dosjen, ata mund të tërheqin kështin, sipas shumës që i takon gjithsecilit.

DOKUMENTET DHE AFATI

Përfituesit e kështit të tretë duhet të dorëzojnë llogarinë bankare edhe certifikatën. Vetëm 3 muaj afat do të kenë në dispozicion trashëgimtarët për të dorëzuar dokumentet që nevojiten

Ish-të përdjekurit, kështi i tretë për 500 trashëgimtarë

Trashëgimtarët e kështit të tretë duhet të dorëzojnë dokumentet

pranë Drejtorisë së Pagave dhe Dëmshtëpërblimeve. Kjo vlen për familjarët e rreth 200 ish-të dënuarve. Përkundër të dënuarve që jetojnë, të cilët mjaftohen duke dorëzuar vetëm certifikatë familjare dhe numër llogarie, lista e kërkesave për trashëgimtarët është më gjërë. Nga këta të fundit për lëvrimin e çdo kështi kërkohet kopje e letërnjoftimit, numër llogarie, certifikatë vdekjeje, certifikatë e trungrit familjar, dëshmi trashëgimie dhe prokurë. Sipas Ministrisë së Financave, certifikata e vde-

kjes është kusht ligjor për shpërndarjen e dëmshtëpërblimit dhe nuk zëvendësohet me vendim gjykatë, që shpall të vdekur individin. E njëjta gjë vlen edhe për certifikatën e trungrit të familjes, e cila nuk mund të zëvendësohet me certifikatë

negative, të lëshuar nga zyrat e gjendjes civile. Nga ana tjetër, nëse nuk ka një përfaqësues me prokurë, procesi ndërlikohet edhe më tepër, pasi duhet që për nëndarjen e çdo pagese të gjithë përfituesit e radhës së parë dhe të dytë që kanë ap-

likuar të kenë bërë dorëzimin e dokumenteve. Në të kundërt, dosja mbetet e bllokuar. Është pikërisht kjo një ndër arsyet, krahas pamjaftueshmërisë së fondit, ajo që ka sjellë ngadalësim të procesit për këtë kategori.

KËSTI I TRETË PËR 500 TRASHËGIMTARË

Table with 30 columns listing names and family members of beneficiaries. Columns include names like FËLLENXE, QEMAL, SALI, SPAHIA, etc., and their respective family members.



Mundësi e shkëlqyer për studentët shqiptarë

Program veror punësimi në SHBA, ja çfarë duhet të dini

Të gjithë studentët shqiptarë e kanë një mundësi të re nga sot. Ambasada amerikane i fton të bëhen pjesë e një programi

veror për punësim dhe udhëtim përreth Shteteve të Bashkuara. "Programi Veror i Punësimit dhe Udhëtimit është një pro-

gram i mrekullueshëm për studentët e universiteteve, të cilët dëshirojnë të kalojnë një verë duke punuar dhe udhëtuar për-

reth Shteteve të Bashkuara. A keni menduar të aplikoni për një program shkëmbimi kulturor? Më thoni ju lutem nëse keni pyetje rreth Programit Veror të Punësimit dhe Udhëtimit apo pyetje rreth kategorive të tjera të vizave! - thuhet në njoftimin e Ambasadës së SHBA.

Historia e 45-vjeçares Alma Gjoni, gruas që merr më shumë ilaçe se bukë

Jeton në skamje me dy djem të sëmurë, e reja: Ndihmomëni!

Të rinjtë: Po na zë shtëpia brenda, ja ëndrra jonë

SHKODER

Në dhomën e lyster me të verdhë, me suva të rënë vende-vende, me dy shtretër mbuluar me batanije të vjetra që ndahen nga një lavatriçe dhe legeni që mbledh pikat sa herë bie shi, jeton kjo familje nga Malësia e madhe. Banja e ulët shtruar me çimento shërben edhe si vend gati, ku një tenxhere dhe kavanozë të pakët janë çdo gjë që ofron kuzhina e saj. Mes lotësh, e rrethuar nga dy djem që për shkak të sëmundjes së tyre, fytyrat i kanë si të murrosura, e reja tregon dhimbjen që i bëhet edhe më agresive për shkak të fukarallëkut. "Më e vështirë sesa të jetosh, është të rrisësh 2 fëmijë jetimë e të sëmurë...", - thotë 45-vjeçarja Alma Gjoni, e cila prej 7 vitesh rrit e vetme dhe në mes të skamjes 2 djem të sëmurë. Që prej vdekjes së bashkëshortit, barra më e madhe për Almën ishte të rriste dy djem të e saj 23 dhe 20 vjeç, të dy me aftësi ndryshe. Jetesa në një dhomë të vetme për 3 anëtarët e familjes është tepër e vështirë. Kushtet tepër të vështira dhe të mjerueshme e detyrojnë Almën që të gatuajë atë pak ushqim në këtë ambient, i cili shërben edhe si tualet. Ajo thotë se nuk ka asnjë mundësi për t'u siguruar fëmijëve bukën e gojës. Edhe pse marrin KEMP, ai nuk mjafton për të paguar ujë e drita, apo qoftë edhe një pjesë të ilaçeve për djemtë. Djali 20-vjeçar thotë se konsumon më shumë ilaçe se sa bukë për shkak të pamundësive ekonomike. 45-vjeçarja Alma Gjoni lutet që ta dikush ta ndihmojë me banesën, e cila nga dita në ditë rrënohet më tepër. Njëri nga djemtë tregon se nuk ka qenë kurrë i lumtur dhe ëndrra e tij është një shtëpi siç e kanë gjithë të tjerët.



Alma Gjoni



DRAMA

Mes lotësh, e rrethuar nga dy djemtë që për shkak të sëmundjes së tyre, fytyrat i kanë si të murrosura, e reja tregon dhimbjen që i bëhet edhe më agresive për shkak të fukarallëkut. "Më e vështirë sesa të jetosh, është të rrisësh 2 fëmijë jetimë e të sëmurë...", - thotë 45-vjeçarja Alma Gjoni, e cila prej 7 vitesh rrit e vetme dhe në mes të skamjes 2 djem të sëmurë.

Që prej vdekjes së bashkëshortit, barra më e madhe për Almën ishte të rriste dy djem të e saj 23 dhe 20 vjeç, të dy me aftësi ndryshe. Jetesa në një dhomë të vetme për 3 anëtarët e familjes është tepër e vështirë. Kushtet tepër të vështira dhe të mjerueshme e detyrojnë Almën që të gatuajë atë pak ushqim në këtë ambient, i cili shërben edhe si tualet.



PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Njofton se duke filluar nga data 16 Prill 2019 çmimi maksimal i shitjes me pakicë për 1 paketë për produktet e mëposhtme të duhanit me ngrohje është si vijon:

Nr	Përshkrimi i Produktit	Çmimi prej datës 16.04.2019 (përfshirë TVSh-në)
1	HEETS (SILVER LABEL)	320 Lekë/ paketë

Njoftimi bëhet në përputhje me Udhëzimin nr. 2, datë 28.1.2010 të Ministrisë së Financave "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" (i ndryshuar).

PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Rr. Murat Toptani , Qendra e biznesit Eurocol, Kati i 10, 1000 Tirana, Albania
Tel: +355 42 276 670

2 vjet hetime, nga 75 persona të dyshuar, 25 të arrestuar në total

ITALI

Media italiane "Il centro" raporton se policia ka shkatërruar dy familje kriminale në zonën e Chietit, të cilët merreshin me trafik droge. Siç raporton media në fjalë, familjet shqiptare trafikonin drogë dhe kishin arritur të blinin makina të shtrenjta me paratë e shumta që fitonin nga aktiviteti ilegal.

Bëhet me dije se familjet shqiptare të shkatërruara janë Beharaj dhe Shametaj, të cilat shpërndanin drogën në krahinat e Chietit, Pescarës dhe Teramos. Në disa raste, droga dërgohej edhe jashtë Abruzos. Dje, policia italiane arriti të identifikojë 75 vetë të dyshuar si të përfshirë në trafikun e lëndëve narkotike.

Nga 76 të dyshuar, 13 persona përfunduan në burg (4 janë në kërkim). Hetimi ka zgjatur më shumë se 2 vjet dhe tashmë thuhet se është zbardhur gjithçka, për atë sesi vepronin familjet shqiptare në aktivitetin e tyre të paligjshëm. Operacioni çoi në 25 arrestime, sekuestrimin e 300 kg marijuanë, 90 kg hashash, dhe 1 kg kokainë. Në rast se e gjithë sasia e drogës do të shitej në treg, atëherë do të fitoheshin deri në 6 milionë euro. Të dyshuarit, gjithashtu, në biznes me familjet historike rome të tilla si familja Spinelli, ishin në gjendje të siguronin lehtësisht armë. Përkishtë armët, familjet shqiptare në fjalë i përdornin në rastet kur përdornin e drogës nuk jepnin paratë në kohë. Grupi i trafikut të drogës shpesh herë organizonte edhe grabitje.

GRUPI I PARË

Hetuesit italianë zbuluan në zonë dy banda kriminale, të cilat funksionin në zonat e Chietit. Dy familjet shqiptare të dyshuara për aktivitet kriminal janë Beharaj që përpos se merreshin me trafikimin e lëndës narkotike, gjithashtu, kishin marrë përsipër prodhimin e saj. Kastriot Beharaj dyshohet

Trafiku i lëndëve narkotike, policia italiane shkatërron dy familje kriminale shqiptare

Familjet Beharaj dhe Shametaj shpërndanin drogën në krahinat e Chietit, Pescarës e Teramos



6

MLN EURO

Nga 76 të dyshuar, 13 persona përfunduan në burg (4 janë në kërkim). Hetimi ka zgjatur më shumë se 2 vjet dhe tashmë thuhet se është zbardhur gjithçka, për atë sesi vepronin familjet shqiptare në aktivitetin e tyre të paligjshëm. Operacioni çoi në 25 arrestime, sekuestrimin e 300 kg marijuanë, 90 kg hashash, dhe 1 kg kokainë. Në rast se e gjithë sasia e drogës do të shitej në treg, atëherë do të fitoheshin deri në 6 milionë euro.

të jetë ndër personat që kujdesej veçanërisht për trafikun e drogës, të cilën e sillte nga Shqipëria në Itali. Vëllai i tij më i vogël Bushi, ndihmësi i tij i drejtpërdrejtë, ishte i angazhuar "në menaxhimin e bashkëpunësorëve të mëtejshëm dhe u kujdes për dërgesat e marijuanës dhe kokainës".


GRUPI I DYTË

Në shkurt të vitit 2017, u arrestua Bush Beharaj. Ai dyshohet se bashkëpunon

me vëllanë e tij Eltonin. Ndërsa "në skenë" shfaqet edhe figura e Fatjon Shametajt, i njohur si Toni, i cili përveç marrëdhënieve të rëndësishme me vëllazërit Beharaj u vendos si udhëheqës i ri i grupit që tashmë ekziston në vend dhe kryesohet nga një tjetër shqiptar, Orgest Dashi".

Familja Shametaj, pas ndërprerjes së furnizimeve të drogës për shkak

të arrestimit të Bushit, tregoi një aftësi të theksuar për të lëvizur dhe arritur sukses në identifikimin e kanaleve të reja të furnizimit". Disa bashkëpunësorë të familjes Shametaj, pas arrestimeve të "udhëheqësve", kishin hapur një kanal në veri, ku droga arriti nga Spanja. Hetuesit thanë se bandat duhet të futen në burg, për shkak se veprimtaria e tyre është jashtëzakonisht e rrezikshme për shoqërinë.



Bënin namin me grabitje në Itali, shkatërrohet banda shqiptare

ITALI - Policia në Arezzo ka ekzekutuar dje dy urdhër-arreste ndaj dy shqiptarëve, të cilët në bashkëpunim me njëri-tjetrin kishin organizuar disa vjedhje me armë në qendrën e qytetit dhe planifikonin "sulme grabitjesh" në vende të tjera publike në vend. Episodet kriminale ndodhën gjatë mesit të tetorit dhe fillimit të nëntorit të vitit të kaluar, kur grupi synonte 5 institucione publike, të gjitha baret që ndodheshin në qendrën historike të Arezzo, në Via Fiorentina, në zonën Tortaia, në Saione dhe në qendër të komunës së Capolona, shkruajnë mediat italiane. Hetimet treguan se grupi funksiononte në një kujdes të plotë. Ata fillimisht vëzhgonin me kujdes vendin që do ta grabisnin, duke përgatitur terrenin. Anëtarët e grupit hynin në bar, duke pirë një pije, ndërsa papritur ata ktheheshin në të dhunshëm. Për t'u larguar, banditët e dyshuar përdornin makina, shumica e të cilave ishin të vjedhura. Dy shqiptarë u dërguan menjëherë në paraburgim, kurse një i tretë u dëbua nga vendi dhe nuk është më në Itali.

unicef for every child UNITED NATIONS CHILDREN'S FUND (UNICEF) Albania Country office

INVITATION TO BID

Subject: EXTENDED DEADLINE - Sale of UNICEF Office vehicles.

The United Nations Children's Fund (UNICEF) is seeking to receive bids from interested companies/individuals who wish to be considered for the purchase of two UNICEF vehicles.

Please consult UNICEF Albania website at (<https://www.unicef.org/albania/suppliers-and-service-providers>) and UN Albania website at (<http://www.un.org/al/employment-and-procurement>) to get further information on the vehicles, terms and conditions of the bid and to see the photos of the vehicles.

The proposals will be evaluated and selected in accordance with established UNICEF procedures.

The bids must be delivered, in a sealed envelope, which must be clearly marked: "BID for Purchase of UNICEF Albania vehicles" - Name of the entity, - Contact details", to the following address:

United Nations Children's Fund (UNICEF)
Rr. "Skënderbej", ndërtesa e Agjencive të OKB-së, kati i tretë,
Tiranë, Albania
Tel.: +355 4 454 8400
Website: www.unicef.org/albania

Relevant Dates: All interested companies/individuals must submit their bid, not later than **16:30 hr. at 25 April 2019.**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemit të kondicionimit në godinën qendrore të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare"

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 3,400,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në logoninë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemit të kondicionimit në godinën qendrore të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare"

Oftera duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 13 Maj 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË GJYKATA E LARTË

Rr. "Ibrahim Rugova", Tiranë, Shqipëri,

www.gjykataelarte.gov.al

Telefon/Fax +355 257308

NJOFTIM

Sipas nenit 125 të Kushtetutës, nga 9 (nëntë) anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, tre anëtarë emërohen nga Presidenti i Republikës, tre anëtarë zgjidhen nga Kuvendi dhe tre anëtarë zgjidhen nga Mbledhja e Përgjithshme e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.

Në zbatim të këtij detyrimi kushtetues dhe bazuar në pikën 3 të nenit 9, të Ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), Gjykata Kushtetuese ka njoftuar Kryetarin e Gjykatës së Lartë për krijimin e 3 (tre) vendeve vakante si vijon:

1. Me shkresën nr. 49/3, datë 9.1.2017, është njoftuar krijimi i një vendi vakant në Gjykatën Kushtetuese, si rezultat i përfundimit të mandatit të gjyqtarës Vitore Tusha (mandat i plotë)
2. Me shkresën nr. 354, datë 27.09.2018, është njoftuar krijimi i një vendi vakant në Gjykatën Kushtetuese, si rezultat i largimit të gjyqtarit Fatmir Hoxha, në kuadër të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve (mandat plotësues deri në vitin 2020)
3. Me shkresën nr. 60, datë 14.02.2019, është njoftuar krijimi i një vendi vakant në Gjykatën Kushtetuese, si rezultat i largimit të gjyqtarit Gani Dizdari, në kuadër të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve (mandat plotësues deri në vitin 2022)

Për të 3 (tre) këto vende vakante, Gjykata e Lartë ka bërë njoftimet publike përkatëse për shpalljen hapjen e procedurës së shprehjes së interesit të kandidatëve që dëshirojnë të konkurrojnë për plotësimin e tyre.

Sipas nenit 125/1 të Kushtetutës, nenit 7/ç të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" dhe pikave 32 dhe 49 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.3.2019 "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", për pozicionin vakant të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese duhet të shprehin interes më shumë se 3 kandidatë.

Në kushtet kur nga 3 (tre) vendet vakante të shpallura, për vendin e parë kanë shprehur interes 3 (tre) kandidatë, nga të cilat 2 (dy) janë tërhequr nga kandidimi, duke mbetur 1 (një) kandidat i interesuar, për vendin e dytë nuk ka shprehur interes asnjë kandidat dhe për vendin e tretë ka shprehur interes vetëm 1 (një) kandidat, bazuar në vendimin nr. 6, datë 05.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi "Për pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve dhe njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje, Gjykatën e Lartë, për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidatëve" dhe shkresën nr. 102 datë 15.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi drejtuar Gjykatës së Lartë, është e nevojshme që të ripërsëritet nga Gjykata e Lartë procedura për paraqitjen e shprehjes së interesit për secilin vend vakant nga kandidatët që dëshirojnë të konkurrojnë.

Për këtë arsye, në zbatim të nenit 7/ç të Ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", në cilësinë e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, rishpall hapjen e procedurës së shprehjes së interesit të kandidatëve që dëshirojnë të konkurrojnë për këto 3 (tre) vende vakante.

Sipas kuarit ligjor në fuqi, këto vende vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese, janë emërtuesë e Gjykatës së Lartë. Pra, zgjedhja e anëtarëve do bëhet nga Mbledhja e Përgjithshme e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.

Afati i pranimit të kërkesave të kandidatëve, sipas nenit 7/ç të ligjit të sipërpërmendur, është 30 ditë nga data e publikimit të këtij njoftimi.

Mbas kalimit të këtij afati, dokumentacioni i paraqitur nga kandidatët do t'i përcillet Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, i cili është organi kompetent për vlerësimin e kushteve dhe kriterëve të emërimit të kandidatëve. Mbi bazën e këtij vlerësimi, ky Këshill bën edhe renditjen e kandidatëve.

Kriteret dhe kushtet e emërimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese sipas neni 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar) janë si vijon:

1. Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:
 - a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
 - b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;
 - c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;
 - d) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;
 - e) të mos jetë larguar nga detyra për shkak disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
 - f) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.
2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kriterë:
 - a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;
 - b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;
 - c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.
3. Plotësimi i kriterëve të mësipërme vlerësohet në bazë të:
 - a) vjetërsisë së profesionit;
 - b) përvojës së veçantë të kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës, ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese a Gjykatës së Lartë;
 - c) kualifikimeve pasuniversitare dhe trajnimeve në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në një fushë tjetër të së drejtës;
 - d) treguesve shkencorë, ku përfshihen botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike;
 - e) curisur gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik, me një mesatare notash jo më pak se 8 ose të barasvlerëshme me të, nëse arsimi i lartë është përfunduar jashtë vendit ose vlerësimit përfundimtar në Shkollën e Magjistraturës;
 - dh) informacioneve të marra nga institucione të tjera publike.

Në përfundim të afatit të paraqitjes së kërkesave, Lista me emrat e kandidatëve do të publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë. Kjo bëhet në zbatim të nenit 7/ç të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me qëllim që institucionet publike që kanë lidhje me sistemin e drejtësisë, organizatat të shoqërisë civile me veprimtari në mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose të krijuara për mbrojtjen e interesave të përdoruesve të sistemit të drejtësisë të mund të paraqesin opinionet e tyre në lidhje me kandidatët pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI

XHEZAIR ZAGANJORI



Projects on "Social Rights for Vulnerable Groups" and "Migration"

As an international cooperation enterprise for sustainable development with worldwide operations, the federally owned Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH supports the German Government in achieving its development-policy objectives. It provides viable, forward looking solutions for political, economic, ecological and social development in a globalised world. GIZ promotes complex reforms and change processes. Its corporate objective is to improve people's living conditions on a sustainable basis.

Background of the project

Since 2015 GIZ has been supporting the Western Balkan in addressing and fulfilment of social rights for the most vulnerable groups in Western Balkan countries through a Regional Project on Social Rights for Vulnerable Groups/SoRI. The main TC measure is: Key stakeholders have improved conditions for ensuring equal social rights for vulnerable groups in selected municipalities. State actors should be able to fully ensure the social rights of vulnerable groups. Members of vulnerable groups, including vulnerable returnees should be able to demand the fulfillment of their rights on their own. This enables long-term strengthening of social inclusion and reintegration of vulnerable returnees in society and reduces discrimination, reduces de-creases for conflict and encourages peaceful development of the Balkans.

The project is implemented in Albania, Bosnia and Herzegovina, Kosovo, North Macedonia and Serbia in four fields of activity (FA).

1. The FA "social services" promotes the development of local capacities to offer social services;
2. FA "awareness raising and sensitization" informs and sensitises vulnerable groups on their social rights.
3. The FA "funding local social services" advises local actors in the development of approaches to securing long-term financing for social services for vulnerable groups.
4. The FA "dissemination of experiences" connects actors on the regional level, in order to enable the exchange of local experiences.

Since the year of 2015, GIZ has been also supporting the Western Balkan region in dealing with increased migration movements. A set of interlinked regional migration projects cooperated with the regional partner MARRI (Migration, Asylum, Refugees regional initiative) in order to strengthen the capacities of the institutions dealing with asylum seekers, support asylum seekers directly during their short or medium term stay, strengthen municipalities affected by trans-migration flows as well as raise awareness and understanding on different migration-related topics among asylum seekers and local population. Currently, the areas of activity are the following:

1. Strengthening of regional migration governance and institutional development of MARRI
2. Direct support to asylum seekers and local population in the Western Balkans
3. Support for the screening process in Chapter 24 of the acquis communautaire in Albania and North Macedonia

In the framework of these projects, two follow-up projects are currently being developed, which will have a duration until autumn 2022:

- Social Rights for Vulnerable Groups II

- Preventing and Combating Trafficking in Human Beings in the Western Balkans

GIZ Albania seeks the following staff: Office Manager (maternity leave replacement)

A. Responsibilities

The office manager is responsible for:

- under the supervision of the National Coordinator/Project Team Leader ensures that all administrative tasks of the project are fulfilled timely and in a competent professional manner;
- daily secretarial chores of the SoRI-project, THB and the SFF project on migration;
- ensure all needed organizations are made for different events, meeting, trainings, work-shops as seminars, as planned in the project, according to GIZ rules and regulations;
- ensure regular communication and flow of information within the project office in Albania and with GIZ country office;
- ensure regular communication and flow of information with other GIZ SoRI offices dealing with the project (BIH, KOS, MKD, SRB), with the SFF Migration office in Skopje and with other GIZ projects relevant for the fields of intervention of SoRI;
- filing documents in reference files and/or in DMS in line with GIZ's filing rules;
- assisting the National Coordinator and the National Advisor for Albania and other members of the team in their administrative tasks, as needed;
- ensure that financial and administrative tasks are fulfilled in compliance with GIZ rules and regulations;
- preparing Job Cards and contracts for local subsidies and consultancies;
- ensure that regular reports by local subsidy partners are received, reviewed and advanced, reporting and payments are done as per contracts;
- ensure that good flow of information and coordination is maintained with all local, central and international partners of GIZ SoRI.

The office manager performs the following tasks:

B. Tasks

1. Secretarial Work and Services
 - Manages incoming and outgoing correspondence;
 - Answers, screens, forwards and/or returns phone calls and messages;
 - Supports organising administrative and logistical aspects of project activities;
 - Prepares and organises internal and working meetings and takes minutes;
 - Organises the travelling and accommodation of project staff and of incoming international experts;
 - Ensures meeting of visibility criteria of GIZ;
 - Organises study tours abroad;
 - Ensures guests' and experts' comfort;
 - Organizes translations of documents and/or interpretation.
2. Administration
 - Coordinates with the GIZ office on the mode of service delivery;
 - Files the documents in reference files and in DMS in line with GIZ's filing rules;
 - Edits and files reports and project documents;
 - Ensures that computers and software function properly;
 - Supports procurement processes in accordance with guidelines;
 - Supports the implementation of audit and/or monitoring missions.

3. Finance and Accounting

- Supports monitoring and preparing the monthly accounting and financial plans;
 - Manages the Cash Box of the project;
 - Helps monitoring expenses in accordance with the budget;
 - Prepares invoices and receipts for accounting and executes payments and checks for compliance with GIZ rules;
 - Supports in supervising costs and expenditures of the project budget and helps preparing the financial report of the project.
- (These tasks will be taken over by the OM during the first 3 months of employment under guidance of experienced colleague.)

4. Coordination and Communication

- Supports the National Coordinator and the National Advisor for Albania in the communication with partners;
- collects, processes and distributes relevant information.

C. Required qualifications, competences and experience:

- University degree in relevant qualification Finance and/or Business; Management/Administration equivalent of BA or MSc.;
- At least 3 years professional experience in a comparable position;
- Good working knowledge of ITC technologies (related software, phone, fax, email, the internet) and computer applications (e.g. MS Office)
- Very good knowledge of English, knowledge of German would be an asset;
- In-depth understanding of financial planning and accounting;
- Customer and service-oriented attitude;
- Excellent communication and organisational skills;
- Willingness to work in a team;
- Willingness to up skill as required by the tasks to be performed.

Contract conditions:

- Full-time employment
 - Project office in Tirana
 - Assignment period: until 30.09.2019
- Please forward your application until **29th of April 2019**, to GIZ Office Albania by E-Mail: giz-albanien-hr@giz.de, including the following information: Application letter, CV in English (Euro Pass format), references. Only short-listed candidates will be contacted for interviews. Short-listed candidates might be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!

U godit nga rrufeja, Greqia merr vendim për Akropolin

Moti i keq shkaktoi 4 të plagosur, autoritetet: Monumenti historik mbyllet për momentin

Dy ditë më parë mediat greke dhe ato ndërkom-bëtare raportuan se mbi Akropol ranë vetëtimat, të cilat sollën shkatërrim të pjesës ku qëndrojnë rojet e sigurisë dhe shkaktuan 4 të plagosur. Shërbimi meteorologjik grek njoftoi se si rrjedhojë e ngjarjes së ndodhur, monumenti his-

torik do të qëndrojë i mbyllur për disa kohë. Vizitorët në monumentin më të lartë historik të Greqisë u penguan të hynin në vendin e Pantheonit në kodrën e Akropolis në Athinë qendrore, shkruan "Ekathimerini". Moti i keq me

vetëtimat shkaktoi 4 të plagosur, 2 prej të cilëve ishin roje sigurie, ndërsa 2 ishin turistë. Shërbimi Kombëtar Meteorologjik i Greqisë paralajmëroi dje për një stuhitë të fuqishme në Athinë, sidomos pasdite dhe mbrëmje, prandaj bënë

thirrje për mbyllje të monumentit të lashtë. Nga Shërbimi Meteorologjik u tha gjithashtu se mbyllja për disa ditë bëhet për të pasur siguri sa më maksimale për Akropolin vetë dhe turistët që e vizitojnë atë.



Zgjedhjet, kryeministri i Kosovës: AAK, e gatshme t'u bashkohet partnerëve

Kyle Scott, ambasadori i SHBA-ve në Serbi, ka deklaruar se zgjidhja Kosovë-Serbi është e përshkruar në letrën e presidentit amerikan, Donald Trump, që ua ka dërguar dy presidentëve Hashim Thaçi edhe Aleksandar Vučić. Scott tha dje se, "një zgjidhje gjithëpërfshirëse për çështjen e Kosovës duhet të përfshijë njohjen reciproke të Serbisë dhe Kosovës. E gjitha varet nga ju", tha Scott. I pyetur nëse do të këtë presion mbi Serbinë në muajt e ardhshëm, ambasadori e ka mohuar një gjë të tillë. "Sa i përket presionit të ri, jo. Presim që të gjitha palët të kthehen në tryezën e negociatave dhe sa i përket marrëveshjes, gjithçka varet nga të dyja palët", përfundoi Scott. Nga ana tjetër, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, thotë se ka ndryshime kësaj radhe në frymën e Samitit të Berlinit. Haradinaj në konferencën për media e pranon se ka ndryshime në dinamikën e Samitit të Berlinit, duke marrë parasysh deklaratimet dhe shkrimet që po bëhen para këtij takimi. "Është një ndryshim substancial thirrja në Samitin e Berlinit. E kanë ndërruar dinamikën. Nuk duhet të marrim asgjë si përfundimtare. Kjo është një energji e re që po ndodh në prag të samitit. Nuk mendoj që është një vendim final. Janë qëndrimet, mendimet që po jepen, ato që ndikojnë", ka thënë Haradinaj. Ai thotë se marrëveshja me Serbinë duhet të bëhet vetëm me njohje reciproke dhe me rivendosjen e raporteve ekonomike. Sipas tij, vetë pajtimi me Serbinë është kompromis për Kosovën. "Kam bërë thirrje që të ndodhë pajtimi. Pajtimi është kompromis për Kosovën. Pajtimi është njohja reciproke me kufijtë ekzistues dhe rivendosja e raporteve ekonomike", ka thënë Haradinaj. Ndërkaq, përsa i përket gjendjes së politikës së brendshme, Kryeministri i Kosovës ka komentuar edhe një herë mundësinë e shkuarjes të vendit në zgjedhje të parakohshme. Në fjalën e tij, Haradinaj është shprehur se nëse dikush nga partnerët e koalicionit kërkon t'u bashkohet zgjedhjeve, partia AAK është



Ambasadori i SHBA në Serbi, Kyle Scott

Greqia "sfidon" Gjermaninë, hapin çështjen e dëmshpërblimeve

Kryeministri i Greqisë, Alexis Cipras, kërkon të rihapet çështja e dëmshpërblimeve të Luftës së Dytë Botërore me qeverinë gjermane. Ai i është drejtuar me kërkesë parlamentit që t'i japë një mandat për ta vënë në jetë zbatimin e këtij plani. Parlamentin grek zhvilloi më herët një debat në lidhje me dëmshpërblimet, që shteti i Gjermanisë i duhet t'i kryejë Greqisë për dëmet e luftës dhe krimet e kryera gjatë pushtimit nazist në Luftën e Dytë Botërore. Tre vite më parë, një komision ekspertësh vlerësoi se dëmet e shkaktuara nga lufta prej Gjermanisë kundrejt Greqisë përllogariten në 290 miliardë euro.

të e gatshme. "Nuk po bëj përllogaritje se sa do të qëndroj, po mundohem të kryej disa punë në Kosovë. Për shembull çështja e pagës minimale nuk ka të bëjë vetëm me votuesit e Aleancës, por për të gjithë. PDK është parti politike, është legjitime nëse ajo ka një kandidat për kryeministër. Nuk e di se kur do të shkojmë në zgjedhje, ne

si AAK kemi deklaruar se nëse dikush nga partnerët e koalicionit, dikush nga ata dëshiron të ndalojë kontratën, atëherë edhe ne jemi të gatshëm. Por, ne i respektojmë detyrimet që kemi marrë", ka deklaruar Haradinaj. Në fjalën e tij Haradinaj është shprehur i bindur se nuk do të tradhetojë asnjë nga partnerët.

Ambasadori i SHBA në Serbi: Zgjidhja përfshin njohjen reciproke

Haradinaj: Frymë ndryshe në Samitin e Berlinit, dinamikë tjetër

Kandidatët për president, në "gjuhë" për votat e komunitetit tjetër

Në valën e zgjedhjeve presidenciale në Maqedoninë e Veriut, njohësit e çështjeve politike theksojnë se kandidatët kësaj radhe gjatë gjithë fushatës kanë treguar një kulturë të lartë komunikimi, si gjatë debateve televizive, ashtu edhe në takimet e drejtpërdrejta me elektoratin. Në këtë drejtim, Aleksandar Kërzhalovski, analist politik, thotë se gjuha unifikuete do të jetë vendimtare që



qytetarët e Maqedonisë së Veriut të motivohen për të dalë në votime në raundin e dytë zgjedhor, në të kundërt sipas tij, do të jetë shumë problematike arrija e pragut prej 40 për qind, i nevojshëm që zgjedhjet të jenë të suksesshme. "Mbetet e hapur çështja nëse shqiptarët do të mund të motivohen që të dalin për të votuar në raundin e dytë për njërin nga dy kandidatët maqedonas, sepse sondazhet tregojnë se kandidatit shqiptar do ta ketë vështirë të kalojë. Nga këtu buron dhe ulja e toneve me elektoratin shqiptar, në njërin anë kandidati i socialdemokratëve dhe kandidata e opozitës maqedonase", thotë Kërzhalovski. Kandidatja për president të shtetit, Gordana Siljana Davkovski, e cila

mbështetet nga partia maqedonase në opozitë, VMRO DPMNE, thotë se është e vetëdijshme se nuk mund të zgjidhet presidenti e shtetit pa votat e shqiptarëve. Megjithatë, ajo thekson se pret të votohet nga qytetarët shqiptarë dhe jo të marrë vota siç shprehet të 'përllogaritura' nga partitë politike. Nga ana tjetër, Stevo Pendarovski, kandidat konsensual mes socialdemokratëve të kryeministrit Zoran Zaev dhe Bashkimit Demokratik për Integritet (BDI), thotë se do të angazhohet për implementimin e plotë të gjuhës shqipe, si gjuhë e dytë zyrtare në të gjitha portet e shoqërisë, ashtu siç e parasheh ligji. "Çdo njeri që ia do të mirën këtij shteti, veçanërisht politikanët, pasi ta fitojnë besimin e elektoratit dhe unë

nëse arrij të bëhem president i shtetit, do të angazhohem që Ligji për përdorimin e gjuhëve të shtrihet në çdo porë të shoqërisë dhe jo vetëm në presidencë. Sepse mendoj se me gëzimin e kësaj të drejte, qytetarët shqiptarë do të bëhen edhe më besnikë ndaj shtetit", thotë Pendarovski. Ndërkaq, kandidati i pavarur për president i Maqedonisë së Veriut, Blerim Reka, i cili mbështetet nga dy partitë politike shqiptare në opozitë, Aleanca për Shqiptarët dhe Lëvizja Besa, thotë se Ligji i gjuhëve nuk ka nevojë për një shtrirje më të gjerë, por nevojitet një ligj i cili nuk do t'i përcaktojë shqiptarët si përkatësi e 20 përqindëshit. Reka beson se tashmë e ka bindur elektoratin maqedonas që të votojë një kandidat shqiptar për mësim platformës së tij, ku sundimi i ligjit është mbi të gjitha.

"Anti-Krishti është Evropa e bashkuar, e Brukseli është Babilonia e re"

Filozofi sloven: Për 10-20 vjet mund të shpërthejë Lufta e III Botërore

Zhizhek: Armiket e SHBA-ve janë 'kukullat' e manipuluar nga evropianët

Sllavoj Zhizhek është gjithmonë befasues. Mund të mos biem dakord shpesh me filozofin marksist sloven, që konsiderohet nga shumë njerëz një mendimtar heterodoks radikal. Por duke lexuar librin e tij të fundit, "Si një hajdut në mes të ditës" dhe intervistuar në Festivalin e Librit në Romë, del nga mendimi i tij një element shumë interesant që ka kaluar pa u vënë re më parë, veçanërisht në funksion të zgjedhjeve europiane më 26 maj: europeizmi i tij i fortë. "Në një botë ku vendimet merren në mbledhjet konfidenciale të liderëve të fortë", s'ka vend për Evropën siç e njohim. Natyrisht, Trumpi ndihet më i qetë në shoqërinë e udhëheqësve autoritarë, me të cilët ai mund të bëjë biznes, veçanërisht nëse ata veprojnë vetëm në emër të shtetit të tyre". "Amerika e Para", mund të bëjë biznes me "Kina e Para" ose "Rusia e Para", apo pas Brexit "Britania e Para", por jo me një Evropë të bashkuar. Qëllimi i Trump, është të bëjë biznes me partnerë individualë, që mund t'i shantazhojë deri në nënshkrim, prandaj është jashtëzakonisht e rëndësishme që Evropa të veprojë si një forcë e vetme ekonomike dhe politike", thuhet në libër. "Por pse Evropa nuk i pëlqen kaq shumë njerëzve në botë? Trump nuk e honops dot, dhe as Steve Bannon, i dërguari i tij në Evropë, që vjen rregullisht në kontinentin e vjetër me qëllimin e deklaruar për ta shkatërruar atë. Dhe Vladimir Putin, që në teori e kundërshton Trumpin, por që praktikisht po bën sistematisht të njëjtën gjë: nuk i intereson nëse është e majtë apo e djathtë, mbështet pavarësinë e Katalonjës, Mateo Salvini në Itali, Lë Penin në Francë, dhe këshu ta madhe. Vetëm për të shkatërruar Evropën", shtoi Zhizhek me pasion, para audiencës së mbledhur në Romë. "Dhe nuk mundeni as të imagjinoni sa serioze është kjo urrëjtje për Evropën, brenda të ashtuqajturës të djathtës alternative amerikane. Në uebsajtet e saj (e djathta nacionaliste dhe supremacist), filozofi thotë se, "antikrishti është një Evropë e bashkuar, dhe Brukseli është Babilonia e re". Mbi këtë pikëpamje të botës, në libër thuhet ndër të tjera se: "Armiqtë e vërtetë të Shteteve të Bashkuara, nuk janë terroristët islamikë, por kukullat e manipuluar në fshehtësi të madhe nga shekularistët evropianë, domethënë nga forcat e vërteta të antikrishtit që duan të dobësojnë Shtetet e Bashkuara, për të krijuar një Rend të Ri Botëror të udhëhequr nga Kombet e Bashkuara. Në njëfarë kup-



Filozofi sloven, Sllavoj Zhizhek

SLLAVOJ ZHIZHEK

"Në ekonominë globale ka plasur lufta, prandaj është koha të merren masa ekstreme. Evropa duhet të jetë e vetëdijshme, që në s'mund të kthehemi në kushtet që ekzistonin përpara Trumpit. Për t'i dhënë ndëshkimin e merituar Trumpit, nevojitet një rend vërtetë i ri botëror. As Rusia dhe as Kina nuk mund ta krijojnë atë".

PARASHIKIMI

"Prandaj duhet të këmbëngulim në forcimin e Evropës, natyrisht në një bazë më të majtë. Ju mund të thoni që kjo është utopike. Dhe ndoshta është e tillë. Por le të reflektojmë më mirë mbi pasojat: nëse partitë si ato të Salvini dhe Lë Pen, ngjiten në pushtet në shumicën e vendeve, ky do të jetë fundi i Evropës" - thotë Zhizhek.

timi, këto konsiderata janë të sakta: Evropa nuk është thjesht blloku gjeopolitik i radhës i pushtetit, por një vizione globale, që përfundimisht është i papajtueshëm me shtetet-kombe. Pra, çfarë e pengon Evropën të mbledhë forcat e saj dhe të reagojë?" Në dallim nga shumë vëzhgues, Zhizhek nuk e konsideron kohën që jetojmë të krahasueshme me vitet 30 të shekullit XX-të, por më tepër me vitet e para

të atij shekulli. Dekadencia e Perandorisë Britanike, provokoi tensione dhe përplasje shumë të forta ndërkombëtare, për të mbushur boshllëkun e fuqisë që u krijua. Po shkohej pandalshëm drejt Luftës së Parë Botërore, me asnjë që ishte në gjendje ta ndalte atë garë të çmendur. Sipas tij, edhe sot jemi duke dëshmuar rënien e një fuqie, Shtetet e Bashkuara, që prodhon një boshllëk pushteti që duan ta

mbushin fuqitë në zhvillim. Për Zhizhek, edhe tani po shkojmë drejt një lufte, e cila do të shpërthejë pas 10 apo maksimumi 20 vjetësh, dhe që duhet të parandalohet me çdo kusht. "Situata e re, është kaq e mbushur me rreziqe, sa që ajo krijon një mundësi unike për Evropën: të angazhohet në formimin e një sistemi të ri ekonomik botëror, që nuk do të dominohet më nga dollari amerikan, si një monedhë globale", shkruan ai. "Në ekonominë globale ka plasur lufta, prandaj është koha të merren masa ekstreme. Evropa duhet të jetë e vetëdijshme, që në s'mund të kthehemi në kushtet që ekzistonin përpara Trumpit. Për t'i dhënë ndëshkimin e merituar Trumpit, nevojitet një rend vërtetë i ri botëror. As Rusia dhe as Kina nuk mund ta krijojnë atë. Ata po luajnë të njëjtën lojë si

Trumpi, flasin të njëjtën gjuhë si "Amerika (Rusia, Kina) e Parë". Këtë mund ta bëjë vetëm Evropa, edhe pse shpesh për fat të keq ajo ka humbur rastin për të luajtur këtë rol themelor. "Ajo që e ndërlikon më shumë problemin, është se Evropa duhet të përballë me revoltën e saj populiste, të shkaktuar nga mosbesimi gjithnjë në rritje i njerëzve, ndaj teknokracisë së Brukselit, që shihet si një qendër pushteti pa legjitimitet demokratik. Rezultati i zgjedhjeve të fundit në Itali, ishte i tillë që për herë të parë në një vend të zhvilluar perëndimor, populistët euroskeptikë u ngjiten në pushtet", shkruan filozofi në librin e tij të fundit. Dhe ende një pjesë e së majtës në Evropë "e hyzinizon" shumë këtë vizione të Brukselit, i parë nga Zhizhek si një "burokraci e korruptuar dhe ekspertë financiarë që janë jashtë realitetit". "Natyrisht që unë jam shumë kritik ndaj qëndrueshmërisë evropiane. Por jam më i bindur se kurë më parë, se Evropa është ende një ide tepër e fortë: liria, solidariteti, të drejtat e njeriut, dhe madje edhe një siguri e caktuar sociale që vjen nga mirënjohje publike, dhe këshu me radhë". "Emigrantët besojnë në shumë tek Evropa se sa vetë ne", thotë i hidhëruar filozofi sloven, i cili na fton të konsiderojmë në dashamirësi të gjitha arrijtet, të etiketuara prej tij si "të pabesueshme" të demokracive sociale skandinave, dhe ato të Evropës Perëndimore. "Dua të jem

brutal, dhe të them diçka që mund të duket e çuditshme, për dikë që pretendon të jetë komunist: në historinë e njerëzimit, nuk ka pasur asnjëherë një numër kaq të madh njerëzish që jetonin kaq të lirë, të sigurtë dhe të mbrojtur nga sistemi i mirënjohjes si në Evropën Perëndimore, të 70 viteve të fundit". Disa nga vendet tona, janë sjellë sigurisht në të kaluarën si fuqi të dhunshme koloniale, dhe tema e përgjegjësisë të tyre historike, është shumë e artikulluar dhe e ndërlikuar, "por ajo që më pëlqen", shpjegon Zhizhek, "është ajo që unë e quaj mazokizmi i të majtës evropian". "Shumë të majtë, ndihen kaq shumë në faj, sa që çdo gjë e keqe që ndodh në vendet në zhvillim, duhet të jetë domosdoshmërisht faji i kolonializmit evropian". "Prandaj duhet të këmbëngulim në forcimin e Evropës, natyrisht në një bazë më të majtë. Ju mund të thoni që kjo është utopike. Dhe ndoshta është e tillë. Por le të reflektojmë më mirë mbi pasojat: nëse partitë si ato të Salvini dhe Lë Pen, ngjiten në pushtet në shumicën e vendeve, ky do të jetë fundi i Evropës", thotë Zhizhek. Kërcënimi i vërtetë për kontinentin e vjetër, vjen pikërisht nga ata që e shpallin veten mbrojtës të kufijve dhe qytetërimit të saj. "Populistët e sotëm antiemigrantë, janë sot kërcënimi real për zemrën emancipuese të Iluminizmit Evropian. Një Evropë që do të kishte në pushtet njerëz si Marin Lë Pen apo Gert Wilders, nuk do të jetë me e tillë", shkruan Zhizhek në libër. Filozofi sloven, që në librin e tij sulmon ashpër presidentin francez Emanuel Makron, e cilëson "një zgjedhje të mjerueshme" propozimin ndaj votuesve francezë midis Makron dhe Lë Pen, teksa vlerëson liderët më të majtë të partive progresiste evropiane. Ai kritikoi edhe Partinë Laburiste Britanike, duke u përqëndruar pikërisht në "ftohësinë e saj" në lidhje me anëtarësimin në Bashkimin Evropian. "Prandaj, është absolutisht e rëndësishme që e majta evropiane, të mbetet pan-evropiane. Edhe Xheremi Korbin ende nuk e ka kuptuar, se kapitali ndërkombëtar nuk mund të luftohet jashtë Evropës. Dhe ky është konflikti i madh, që ka sot e majta".

Marrë nga Bota.al

Xhamia e shenjtë u dogj në një ditë me Notre Dame

Izrael, tym e zjarr nga çatia e dhomës së faljes, zjarrfikësit: S'ka dëme



Xhamia Al-Aksa në flakë

jetë shkaktuar nga fëmijët që po luajnë rreth e rrotull xhamisë. Al-Aksa, e njohur për hebrejtë si Mali i Tempullit, është vendi i tretë më i shenjtë i Islamit dhe në qendër të konfliktit të vazhdueshëm arabozraelit. Megjithatë, ky incident mbeti në hije për shkak të zjarrit masiv që përfshiu katedralen e Notre Dame, në të njëjtën kohë.

Një zjarr ra në xhaminë Al-Aksa, në Jeruzalem, në të njëjtën kohë që katedralja Notre Dame e Parisit digjej. Pamjet e publikuara në Twitter tregojnë tym e zjarr që dilte nga çatia e dhomës së faljes. Sipas zëdhënësit të policisë izraelite, Micky Rosenfeld, zjarrfikësit shkuan me shpejtësi në vendngjarje dhe arritën t'i vinin flakët nën kontroll brenda pak minutave. Si pasojë e zjarrit nuk pati të lënduar, apo dëme në strukturën e xhamisë. Policia atje po heton shkaqet e ngjarjes, por ka dyshime se ai mund të

Rrëfihet këngëtarja: E veçanta e projektit të fundit, frymëzohem nga vokalet e bukura

Blerina Matraku:

Performancat live i shoh si të shenjta, muzikën e ndiej në inde

"Artisti duhet të japë maksimumin për të marrë atë që do nga publiku"

Egla Xhemali

Tingujt e muzikës janë të dashur për shpirtin, ashtu siç është ajo për publikun. Një artiste e jashtëzakonshme, që ka ditur të rritet profesionalisht me punën e palodhur e duke i mëshuar fort talentit të saj. Padyshim që e njihni të gjithë Blerina Matraku, që për shumëkënd identifikohet si një nga këngëtarët më të pëlqyera të "Maratona e Këngës". Bukuroshja vjen në një rrëfim për "Gazeta shqiptare", për të ndarë me ne të pathënat e botës së muzikës dhe përtej shkëlqimit të saj. Ndër të tjera arrimë të zbulojmë se artistja ngelet po e njëjta edhe kur heq delirin e profesionit që ka. Fundja një artist nuk mund të quhet i tillë nëse nuk është i thjeshtë me ata që e duan e që e ndiejnë muzikën e tij. Matraku na tregon për punën intensive dhe për rikthimin e bujshëm që pritet nga dita në ditë, për Blerinën me shpirtin plot ngjyra që rrezaton pozitivitet, si dhe për detaje që rrallëkush i di për këngëtarën. Për të gjithë ata që mezi e presin projektin e fundit të saj, Blerina ka rezervuar një surprizë. Shumë shpejt do jetë gati për ju!

Blerina, publikun e ka marrë kaq shumë malli për ty! Si do ta rifitosh kohën e humbur?

Përsëendetje! Mendoj se kohën do ta rifitoj me nivelin artistik që do të sjell në këngët dhe në klipet e mia të reja. Të them të vërtetën, jam në punë e sipër për një këngë dhe një klip shumë të bukur, ritmik dhe goxha interesant. Uroj ta mbush siç duhet mungesën time edhe pse nuk është se kam munguar shumë, sepse në "Maratonën e Këngës" gjatë verës së 2018 solla një këngë shumë të bukur nga mbrëmjet e së cilës krijova edhe një klip interesant ku edhe e kam publikuar me titull "Më duj". Është pëlqyer mjaft nga publiku



dhe për këtë jam shumë mirënjohëse. Dhe falënderuese.

Si nis ideja e një kënge më pas, e një klipi për ty?

Frymëzohesh nga një

tekst, nga një melodi, një muzikë... Çdo artist ka muzën e tij që e frymëzon dhe mbi të cilën jetëson krijimin e tij. Unë kam Lara Fabian, Indilën... frymëzohem nga

vokalet e bukura.

Një këngë që nuk është për shijen tënde?

Një këngë që nuk është kënduar bukur. Një talent tjetër me të cilin je bekuar,

veç këngës? Të bëj sport. Kam shumë e lidhur me sportin dhe natyrën, do kaloja orë të tëra aty.

Kënga më me vlerë shpirtërore që ke realizuar deri më tani?

"Paris" është kënga më e bukur, nuk mendon edhe ti kështu?! (qesh)

Në duart e kujt do ta lije me kënaqësi zërin tënd?

Në duart e Zotit.

Në ç'pikë do të doje të përsosesh akoma?

Në performancë. Jo se gjej shumë gabime, por gjithmonë kërkoj më të mirën.

Çfarë ke bërë mbrëmë?

Mbrëmë kam qenë në mbrëmje live, e adhuroj të kënduarin live, të ndjesh muzikën gjallë, këngën deri në indet më të vogla.

Çfarë kërkon nga Blerina publiku para të cilit këndon pothuajse çdo natë?

Unë, thjesht këndoj me gjithë zemër. Unë e di që publiku këtë do, të këndoj me shpirt, me dashuri, të këndoj vërtet, të humbas në këngë, të vallëzoh me këngën.

Je mërziut ndonjëherë duke kënduar?

Akoma jo dhe nuk besoj se do të mërziitem ndonjëherë. Je vajzë tërheqëse...

Çfarë ka pozitive dhe çfarë jo, në këtë fakt?

E bukura është të ndihesh shumë mirë, e realizuar dhe që këtu më pëlqen që gjërat e bukura të pëlqehen dhe kërkojen nga publiku.

Cili ka qenë qëllimi fillestar në rrugën tënde artistike dhe cili është tani?

Muzika është shumë afër perëndisë e duke qenë aq afër qëllimi kryesor ka qenë t'i bëja njerëzit të ndihen mirë përmes zërit dhe pse jo kjo gjë të jetë një vazhdimësi. Doja që zëri im të dëgjohet. Secili ka mënyrën e tij për të depërtuar tek të tjerët dhe mënyra ime ishte kënga. Tani, qëllimi im është të bëj këngë sa më të bukura dhe t'i jap diçka pozitive kësaj bote të mbingarkuar

me probleme.

Cili është vendi më i përshtatshëm në botë, për të qenë femër?

Ai vend është kudo ku ndihesh mirë dhe e vlerësuar.

Vajzat e mira apo ato të këqija ecin më shumë në jetë?

Nuk ka vajza të këqija apo të mira, ka situata të cilat na bëjnë të këqija apo të mira. Unë jam e mendimit se vajzat që kanë arritur shumë, kanë pasur vizion dhe fokus në qëllimet e tyre.

Është e lehtë të marrësh nga publiku atë që do?

Nuk është edhe aq e lehtë. Po të ishte ashtu, nuk do të kishte vazhdimësi artistike. E theksoj që një artist duhet të japë maksimumin për të marrë atë që do nga publiku.

Është më mirë të dyshoh apo të besosh?

Asnjëra nga të dyja. Gjithsesi, njeriu duhet të besojë diku, përndryshe nuk mund të jetojë. Nuk ka se si të jetojë pa besim.

Sa njerëz interesantë ke njohur kohët e fundit?

Interesantë? Të gjithë njerëzit janë interesantë në mënyrën e tyre.

A e konsideron veten të suksesshme?

Përdërisa ka më të suksesshëm, do të thosha, relativisht e suksesshme.

Cilat janë ato gjëra të bukura të cilat ia vlen të jetojen në jetë?

Gjërat më të bukura, për t'u jetuar janë. Të bëshesh ai apo ajo që gjithmonë ke dashur, pasardhësit, e mira, e keqja, të gjitha janë pjesë e jetës. Të gjitha duhen jetuar, madje edhe dhimbja. Nuk do të lija pa e ripërmendur natyrën. Njeriu nuk jeton dot pa natyrën.

Është më mirë të kesh shoqe apo shok të ngushtë?

Nuk është e rëndësishme shok apo shoqe, e rëndësishme është të kesh një mik(e) të mirë.

Projekti yt i endrrave, cili është?

Të vazhdoj të endërroj, të realizoj e të ndihem mirë, projektet të cilat publikohen janë të gjitha pjesë e ëndrrave tona.



Pas largimit nga OTR, Oriola bëhet pjesë e brandit botëror

Pak ditë më parë lajmi se marrëdhënia mes modeles Oriola Marshi dhe reperit Noizy ishte prishur mori vëmendjen e të gjitha mediave. Dyshja nuk e ndiqte më njëri-tjetrin në 'Instagram' gjë që ngriti dyshimet se ata i kishin dhënë një herë e mirë fund miqësisë dhe kjo nuk është hera e parë që e bëjnë këtë. Madje modelja seksi hoqi edhe pershkrimin nga BIO që tregonte se i përket grupit OTR, mirëpo karriera e saj po njih vetëm ngritje. Së fundmi, nëpërmjet 'Instagramit', Oriola na ka treguar se ndodhet në Lugano të Zvicrës dhe jo për qejf, por për punë. Ajo ka publikuar një video në 'Instastory' ku shkruan se sapo ka mbaruar fotosesionin me brandin e njohur botëror GUESS. Ne i urojmë asaj suksese dhe shumë fat në këtë rrugëtim të ri!




"Më paska ikur dielli nga Londra!" Arbana Osmani flirton publikisht me regjisorin

P prej ditësh përfillet se Arbana Osmani dhe regjisori i emisionit të saj janë në një lidhje dashurie, mirëpo ata s'e kanë pranuar asnjëherë publikisht. Ajo që shton edhe më dyshimet janë veprimet që kanë bërë në rrjetet sociale, aq më tepër komentet e ditës së djeshme. Arbana ka publikuar një foto ku duket si gjithnjë mjaft në formë, ndërsa regjisori i komenton: 'Mos, prandaj më paska ikur dielli nga Londra mua'. Moderatorja i është përgjigjur menjëherë duke i shkruar: 'Shih mos të të iki ndonjë kërmill nga pjata ty'. Kjo replikë e Arbanës është pasuar me një tjetër koment, emoji, me gjuhën jashtë e sytë zemra nga regjisori.



Pse bëhet xheloz Besi? Xhensila tregon ku qëndron problemi

Xhensila Myrtezaj dhe Bes Kalaku janë një prej çifteve me të dashur të show bizz-it shqiptar. Para disa muajsh ata u bënë prindër për herë të parë me një vajzë, të cilën e pagëzuan me emrin Ajka, por vogëlushen kanë vendosur ta mbajnë larg rrjeteve sociale. Mirëpo siç duket Ajka e ka bërë pak xhelozë mami Xhensilën. Këngëtarja publikoi një video ku tregon se, aktori i humorit është bërë shumë xheloz dhe "fajtorë" për këtë sipas tij është vogëlushja e tyre. "Që pas lindjes së vajzës, ky djali këtu që duket i gëzuar, me humor, është bërë shumë xheloz edhe më thotë që ke filluar të mos më duash siç më ke dashur më përpara, ma ka marrë dashurinë Ajka. Por, unë i them që nuk e dua dot më pak", shprehet këngëtarja në videon e postuar në Insta Story, ndërsa në sfond nis kënga e Klajd Harunit "Nuk të dua dot më pak". Gjatë videos të dy shfaqen të qeshur, ndërsa duket se po udhëtojnë me makinë.



Të gjithë po presin bashkëpunimin e tyre! Zbuloni çfarë thotë Fero për Getoarin

Fero është kthyer shpejt në një prej reperëve më të komentuar në showbizz. Edhe pse mjaft i ri suksesi i tij duket se është gjithmonë e më shumë në rritje, dhe para pak kohësh mësuam se reperi i ri do të vinte në një bashkëpunim me Ghetto Geazy, por duke qenë se ende nuk po shohim shenja të këtij projekti duket si një mit. Megjithatë Fero mbetet një fans i Getoarit dhe muzikës së tij dhe së fundmi, ai ka publikuar në 'Instastory' e tij disa video ku shfaqet duke dëgjuar këngët e Getoarit, të cilin e ka etiketuar dhe i ka vendosur emojiin e një dhie.



BOTIMI

"Dritëhijet" e ish-Sigurimit, del revista e Muzeut të Përgjimeve

Nga demaskimi i Theofan Popës, te rrëfimi i burgut nga Tomorr Aliko

Periudha e liberalizimit, që u shënjua nga romani i Kadaresë e Markos

Fatmira Nikolli

Ezeza dhe e bardha të mpleksura me njëra-tjetrën. Mister dhe sekrete. Edhe brenda muzeut, tekstet e shkruara, panelet, diciturat dhe imazhet janë bardhezi. Sektorë me pamje, filmime, dokumente dhe fotografi, me dritëhije ku e zeza shërben si shenjim i misterit dhe i sekretëve që bart godina. Histori agentësh, bashkëpunëtorësh, emra të fshehur e të zbuluar, viktimë që kthehen në bashkëpunëtorë dhe bashkëpunëtorë që kthehen në viktimë, përgjues e të përgjuar. Del për publikun numri i parë i revistës muzeologjike "Dritëhije", një botim i Muzeut Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me gjethe". Ajo u promovua të enjten dhe synimi i saj është të nxisë njohjen dhe studimin e periudhës së komunizmit shqiptar duke publikuar dhe shpërndarë fakte mbi regjimin diktatorial, mbi dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit, kontrollin e përndjekjen e qytetarëve si dhe probleme të muzeologjisë postkomuniste e të trashëgimisë kulturore. Drejtoresha Etleva Demollari tha para mediave se u zgjodh emri "Dritëhije" për shumë arsye. "Dritëhije" na kujton pandashmërinë midis të zezës dhe të bardhës, qartësisë dhe errësirës, pozitivës dhe negativës, njohurive dhe injorancës. Këto dy pole, dukshëm të papajtueshme janë në fakt të dënuara për të jetuar një dinamikë të përhershme të ndërlikues/opozitës, drita dhe hija. "Shtëpia me Gjethe"... Gjethe që e rrethojnë këtë shtëpi, mbulojnë dritën e diellit dhe krijojnë hije. Rreze drite që arrijnë të depërtojnë. Hijë që zgjaten e përpiqen të mbulojnë sa munden", tha ajo. Në këtë revistë që nisi dje rrugëtimin do të publikohen ngjarje, personazhe e figura historike kombëtare të veshura me dritëhije.

Vende, ngjarje e figura të fetishizuara e glorifikuara, të mohuara, të nxira, të anatomuara të cilat presin vlerësim të qetë e objektiv, mbështetur në dokumente e në logjikën e historisë, larg sasive, thashethemeve e manipulimeve.

REVISTA

"Me anë të kësaj reviste kërkohet shumë modestisht, falë kontributit të bashkëpunëtorëve tanë, studiues, historianë e dëshmitarë të kohës, muzeologjë të hedhim dritë, dritë që buron nga kujtesa, nga dokumentimi i krimeve të diktaturës dhe totalita-



rizmit komunist, nga kujtimi i atyre që mundën të mbijetojnë e që davarit zezonën. Këtë mësojmë të tregojmë me "Dritëhije-n", tha Demollari. Në botim gjenet një përpjekje për të treguar rolin e Muzeut Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe" në përkujtimin e dhunës gjatë regjimit komunist në kuadër të drejtësisë tranzicionale si muze, memorial dhe vend kujtese i një trashëgimie të vështirë dhe mënyrën se si mësohet mbi komunizmin në muze. "Rrëfimi në muze bëhet nga pikëpamje të ndryshme: Këndvështrimi i të dënuarve të regjimit komunist jepet përmes dëshmiave gojore. Në dosjet dhe dokumentet e tjera arkivore të kohës jepet pikëpamja e Sigurimit mbi bashkëpunëtorët apo viktimat e terrorit komunist. Përmes tyre, në mënyrë të tërthortë mund të kuptohen dhe metodat që përdorte Sigurimi për rekrutimin e bashkëpunëtorëve. Ndërsa nëpërmjet paneleve, diciturave, statistikave jepet pikëpamja e Muzeut. Muzeu

duke shfrytëzuar të gjitha mjetet muzeografike dhe duke paraqitur këndvështrime të ndryshme jep një kontribut të vyer në diskursin aktual mbi të shkuarën, në njohjen e fakteve, në rivendosjen e dinjitetit të viktimave, në nxitjen e debeteve të hapura midis padrejtësive të kaluara duke siguruar dhe një vend për reflektim", - tha Demollari. Ajo fjalëderoi studiuesin Kastriot Dërvishi, që ka qenë mbështetës sepse falë dokumenteve e dëshmiave të siguruar prej tij, Muzeu ka mundur të realizojë ekspozitën dhe aktivitetet të ndryshme. Në këtë botim ai sjell një kontribut informues mbi veprimtarinë e Sigurimit të Shtetit. Në të del në pah se si kalohej nga procesi agjenturor-operativ i fshehtë, përndjekja e fshehtë në procesin hetimor gjyqësor, ndjekja ligjore.

MATERIALET

Drejtori i Muzeut Kombëtar, Dorian Koçi, i cili në revistë boton një material mbi tranzicionin kulturor në Shqipëri dhe kapërcyellit të viteve '90. Sipas tij, në mes të viteve '80, me vdekjen e diktatorit Hoxha, ashtu si Hrushovi në mes të viteve '50 me vdekjen e Stalinit, fillon liberalizimi i kontrollit total të Partisë së Punës duke inkurajuar fillimisht lirinë kulturore. Por, ndryshe nga Hrushovi që refuzonte vazhdimësinë totalitare të Stalinit, Ramiz Alia ishte i detyruar nga sfondi politiko-ekonomik i vendit dhe i Europës Lindore.

Në 1987 - Koncerti i Albanos dhe Rominës në Shqipëri - 2 këngëtarë të njohur italianë, të cilët kënduan e performuan rrymë muzikore për të cilat kishte njerëz që ishin dënuar me burg theu tabutë e shijëve estetike të imponuara me forcë. Përmendet

edhe botimi i romanit të Kadaresë "Koncert në fund të dimrit 1987" apo "Nata e Ustikës" 1989, që janë shembuj të fillimit të liberalizimit. Megjithatë Koçi vëren se ka sot mungesë të një etike të re kulturore. Boshllëku që ka lënë kulturore. Studiuesi i marrëdhënieve shqiptaro-gjermane Dr. Marenglen Kasmi ndalet të "Stasi dhe përvoja gjermane për hapjen e dosjeve". Shënon se debati për hapjen e dosjeve të Sigurimit të Shtetit përbën ndoshta një nga çështjet që ka ngacmuar dhe intriguar më tepër publikun shqiptar në këto 28 vitet e fundit. Sipas tij, në vendet e tjera të ish-Blokut Lindor, dosjet e shërbimeve sekrete janë hapur. Modeli më i përsosur për hapjen dhe aplikimin e këtij procesi është ai i ndjekur në Republikën Federale Gjermane, ku me ligj është rregulluar regjistrimi, hapja, administrimi dhe përdorimi i dokumenteve të Ministrisë së Sigurimit të Shtetit dhe organizatave para- dhe pasardhëse të saj në ish-Republikën Demokratike Gjermane. "STASI nuk ishte një shërbim i fshehtë i zakonshëm, por një polici sekrete me institucione paraburgimi, aparate hetimi, burgje, si edhe prokurorë e gjykatës të posaçëm. Detyra kryesore e STASI-t ishte sigurimi dhe ruajtja e pushtetit të Partisë në pushtet". Ai veçoi se në mëngjesin e 4 dhjetorit të vitit 1989, dega e STASI-t në Erfurt u pushtua nga qytetarët, pasi u bë e njohur se po përgatitej zhdukja e dosjeve të STASI-t. Po në këtë ditë, banorët e Lajpcigut dhe Rostokut

pushtuan zyrat e STASI-t. Për të ruajtur dosjet qytetarët krijuan Rojen Civile dhe Komitetet e Qytetarëve. Revolucioni paqësor gjerman mori përmasa më të mëdha dhe më 15 janar 1990 u pushtua nga qytetarët edhe qendra e STASI-t në Berlin. Kësajsoj u sigurua së pari ndalimi i asgjësimit të dosjeve nga punonjësit e Sigurimit. Ajo që kërkoi demonstruesit ishte ballafaqimi i të interesuarve me këto dosje. Së pari më 2 janar 1992 u mundësua që qytetarët të kishin mundësi të shikonin dosjet e tyre. "Përvoja gjermane merret në shumë shoqëri me një të kaluar moniste si modeli i ballafaqimit të një shoqërie demokratike me të kaluarën diktatoriale të vendit. Hapja e dosjeve të Sigurimit të Shtetit në vendin tonë përbën një sfidë jo vetëm në pikëpamje politike e juridike, por edhe profesionale. Për këtë arsye, njohja me përvojat e tjera, e sidomos atë gjermane, është një domosdoshmëri për kryerjen në mënyrë sa më transparente të këtij procesi", vëren Kasmi.

Studiuesi Andrea Llukani boton në numrin e parë studimin "Ndihmesa e Theofan Popës për muzeologjinë shqiptare". Shënon se Theofan Popa, teolog me një kontribut të çmuar në mbledhjen e mbishkrimeve dhe objekteve liturgjike kishtarë, kundërshtoi prishjen e shumë kishave dhe bashkë me Gani Strazimirin, Aleksandër Meksin dhe Pirro Thomson shpëtuan rreth 120 kisha dhe manastire, duke u dhënë statusin e monumenteve të kulturës. Ai u demaskua publikisht dhe i biri u arrestua për veprimtar armiqësore. Në fund është një material nga Tomor Aliko me temë "Pasqyrimi i burgjeve dhe kampeve të internimit gjatë regjimit komunist". Trajton gjyqin e parë special më 1945, rrefen si u eliminua truri i kombit shqiptar me vendime të gjyqeve speciale dhe ato ushtarake, varjet në litar, ekzekutimet, burgosjet. Tomor Aliko është njëri nga të mbijetuarit e regjimit komunist. Ai ka qenë njeri nga të rinjtë antikomunistë, i cili provoi torturat dhe merrret në burgjet dhe qelqitë e diktaturës për shkak të bindjeve të tij antikomuniste. "Me botimin e kësaj reviste kemi bërë një hap modest në ndriçimin e disa aspekteve të periudhës së regjimit komunist dhe të mënyrës së pasqyrimit të tij në muze. Botimet të tjera do të pasojnë e shpresojmë që do të kontribuojnë sadoqap në davaritjen e hijeve që rëndojnë mbi këtë periudhë e mbi gjithë shoqërinë tonë", tha Demollari.

KINEMATOGRAFI

EDUART MAKRI

Regjisori i "Shpellës së Piratëve"
drejton Qendrën e Kinematografisë

*Ikën nga detyra Ilir Butka, regjisorët
stature prekëse për të*

*Kush është drejtori i ri që 'vendos' për
filmat shqiptarë*

Fatmira Nikolli

Qendra Kombëtare e Kinematografisë tashmë do të drejtohet nga regjisori Eduart Makri. Kontributi i tij njihet në kinemanë shqiptare, por edhe në teatër. Prej vitit 2000, ai ka jetuar dhe punuar në Kanada. Eduart Makri ishte në garë me Yllka Gjollshën, producenten Elkjana Gjipali dhe kineastin Ilir Butka. Ministria e Kulturës, Elva Margariti, i propozoi kryeministrit Edi Rama ish-drejtorin Ilir Butka dhe Eduart Makrin për Qendrën Kombëtare të Kinematografisë dhe shefi i qeverisë miratoi emrin e Makrit. Kanë qenë të shumë kineastët që janë zhgënjyer nga ky vendim, teksa kanë shprehur mirënjohjen e tyre për bashkëpunimin me Butkën. Bujar Alimani shkroi mes të tjerash se "jeta është e gëzueshme dhe asgjë s'do marrin në fund me vete, gjithçka këtu do ngelet. Veç disa gjëra natyrisht i mbajmë brenda vetes, i mbartim e udhëtojmë me to. Një nga këto gjëra ka qenë miqësia jonë, e cila do bëhet me e fortë në ditët që do vijnë. Miqësitë në kohët tona janë të rralla, por unë e konsideroj të tillë tonë, e cila nis që nga TIFF e para dhe me vitet e fundit tejkaloi edhe institucionin që ti drejtoje. E tejkaloi sepse personalisht nuk konsistojta thjesht në kalim projektsh. Jam shumë i lumtur që me ty si mik dhe si drejtues i atij institucioni nuk lëkundam asnjëherë besimin tënd, nuk i ngatërrova këto të dyja kurrë e shpresoj shumë me çfarë kam bërë në filmat e mi të jesh gëzuar dhe ti". Vetë Butka njoftoi të mërkurën se, "sot nuk do të jem në drejtimin e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë". Ai i uroi suksese kryetarit të ri punë të mbarë dhe suksese dhe falënderoi të gjithë ata që ndanë me të këtë rrugëtim të përleshkët gjatë këtyre viteve dhe kineastët, që i dhanë vlerë punës me krijimet e sidomos ata me suksese ndërkombëtare.

Më tej edhe Robert Budina ka shkruar me respekt dhe mirënjohje për punën e Butkës si kryetar i QKK për gjithë këto vite. "U përpoqe me mundësitë që kishte të vije standarde ndryshe në kinemanë shqiptare, që nuk mund të mos i përmend jo vetëm unë, por të gjithë ata që kanë punuar këto vite me institucionin që drejtoje: U krijoje mundësitë shumë kineastëve



Eduart Makri

të rinj të realizonin ëndrrat e tyre, nxite institucionet përkatëse që kinematografia shqiptare të bëhet pjesë e Creative Europe, krijoje mundësinë e bashkëprodhimeve minoritare. Me këmbëngulje të paepur rrite buxhetin e QKK, rrite prodhimtarinë e filmave shqiptarë, u krijoje mundësinë producentëve shqiptarë të integroheshin me skemat europiane të prodhimit të film-it, rrite kontaktet me institucionet europiane të filmit, rrite aktivitetet që sillnin producentë dhe distributorë europianë në Shqipëri, krijoje mundësinë që të rriteshin sukseset e filmave shqiptarë në festivalet më prestigjiozë botërorë, ishe afër nga ana njerëzore me kineastët që përballëshin vazhdimisht me probleme", shkroi Budina. "Trishtimi im nuk është se ti nuk je më kryetar i QKK, sepse jam shumë i bindur që ti do të dish ta vazhdosh karrierën tënde artistike dhe produktive, trishtimi im është se puna, profesionalizmi dhe

ndershmëria në këtë vend nuk janë kriteret për politikëbërësit për të zgjedhur drejtuesit e institucioneve, por ky nuk është vetëm faji i tyre, ky është mentaliteti ynë që prodhojmë të tillë politikëbërje! Gjithsesi, me mundësitë që u krijoje, bëre më shumë kineastë të zotë të punës së tyre dhe sigurisht që kur ka njerëz të zotë në punën e tyre, krijohen premisat për ta ndryshuar këtë mentalitet!"

MAKRI

Eduart Makri ka lindur në 5 qershor të vitit 1957 në qytetin e Gjirokastrës. Është aktivizuar që në moshë të re në estradë dhe teatrin profesionist të Gjirokastrës. 14 vjeç ishte pjesë e grupit nismëtar për Teatrin e Kukullave të Gjirokastrës, ku luajti edhe rol në shfaqjen e parë. Pas përfundimit të studimeve të larta në Institutin e Lartë të Arteve (sot Universiteti e Arteve) në degën e Aktrimit filloje punën në Kinostudion "Shqipëria e Re" si regjisor dhe ske-



Ilir Butka

narist. Në kinematografi roli i tij i parë si aktor do të jetë ai i Vasos në filmin "Vëllezër dhe shokë" në vitin 1980. Më tej do të vazhdonin interpretimet të tjera si ai në rolin e Aristotelit në filmin televiziv "Agimet e Stinës së Madhe", Gjergji në filmin "Besa e kuqe", Andrea në filmin "Në emër të lirisë", Pirro në filmin "Shpresa" etj. Në regjisorë pjesëmarrja e tij e parë do të jetë si as. regjisor i dytë në filmin "Plaku dhe hasmi" në vitin 1981, duke realizuar gjithsej 11 regji si asistent regjisor në po kaq filma duke bashkëpunuar me regjisorë të njohur si Gëzim Erebbara (Artist i Merituar), Hysen Hakani, Kujtim Çashku (Artist i Merituar), Xhanfize Keko (Artiste e Popullit) etj. Si regjisor, filmi i parë i drejtuar plotësisht prej tij do të jetë filmi "Shpresa" në vitin 1989 e ndjekur në "Shpella e Piratëve" 1991. Në vitin 1993 fillon punën si pedagog në Akademinë e Arteve. Në vitin 1997 do të zgjidhet Drejtor

Ekzekutiv i Fondacionit të Kulturës dhe Arteve "Pan Noli". Në vitin 1997 do të emërohet drejtor i Departamentit të Filmit dhe Spektaklit në Televizionin Publik Shqiptar. Në vitin 2000 largohet nga atdheu për në Kanada. Në teatër ai do të interpretojë disa role me trupën e Teatrit të Institutit të Lartë të Arteve (sot Universiteti e Arteve) si psh., rolin e Kronstadt në dramën "Hështëpia e kukullës" apo rolin e hetuesit në dramën "Vdekja e një vajze". Me vendosjen e tij në qytetin e Torontos (Kanada) ai do të vazhdojë profesionin e tij. Roli i tij i parë do të jetë ai i Andre Tristan, piktorit në filmin "This is Wonderland" në vitin 2004. Interpretimin e tij më të fundit do të jetë në rolin kryesor në filmin "Missing" Season 3, Episode "Cut" në rolin e Viktor Brosky-t në vitin 2006. Eduart Makri është anëtar me të drejta të plota i ACTRA-s (Alliance of Canadian Cinema, Television and Radio Artists).

DITA E MONUMENTEVE

Monumenti i Agonotetëve, Mnguritit mes gjelbërimit dhe kurorës së ullinjve, u kthye në një prej simboleve të këtij viti, në Ditën Ndërkombëtare të Monumenteve dhe Siteve Arkeologjike, në Shqipëri. Ministria e Elva Margariti zgjodhi pikërisht Apoloninë, një nga parqet më të rëndësishme arkeologjike në vendin tonë, për të dhënë mesazhin e mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore. "Ajo që ndodhi në Paris duhet të na bëjë edhe më të ndërgjegjshëm për trashëgiminë tonë kombëtare, për ta mbrojtur atë dhe nga ana tjetër për ta promovuar edhe më

tepër. Është e rëndësishme që teknologjinë ta përdorim në këtë drejtim. Është një formulë, tek e cila ne besojmë fort, që është ajo e dixhitalizimit për dokumentimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore. Sot mundësitë që na ofron teknologjia të gjithë mund t'i përdorim në shërbim të promovimit të kulturës", u shpreh ndër të tjera ministria Margariti, gjatë prezantimit në Apoloni të projektit 3D-IMP-ACT, të arritjeve të deritanishme nga skanimi deri te printimi 3D. Ministria Margariti,

Margariti: Të përdorim teknologjinë
për promovimin e trashëgimisë

e shoqëruar nga drejtorja e Institutit të Monumenteve të Kulturës, Arta Dollani, si edhe drejtues e specialistë të Parkut, vizituan disa prej monumenteve kryesore të Parkut, si mozaikun në vilën me Impluvium, murin rrethues Veri-Lindor të Manastirit, murin e Temenosit, por edhe Muzeun Arkeologjik dhe ekspozitën fotografike me imazhe nga Muzeu Kombëtar Etnografik Berat, në Trapezarinë e Manastirit të Shën Mërisë. Në vitin 1982, ICOMOS (Këshilli Ndërkombëtar i Monumenteve

dhe Siteve) vendosi datën 18 Prill si Ditën Ndërkombëtare për Monumentet dhe Site, datë e cila u miratua si e tillë në Konferencën e 22-të të Përgjithshme të UNESCO-s të mbajtur në vitin 1983. Që nga kjo periudhë, 18 Prill ka shënuar ditën e kremtimit dhe promovimit të trashëgimisë kulturore dhe është vlerësuar si një mundësi për të rritur ndërgjegjësimin për diversitetin, rëndësinë, nevojën dhe përfitimet e konservimit dhe mbrojtjes të saj.

Opinion

i Ditës

Ç'faj na ka Holanda

Nga Flutura Aça

(vijon nga faqja 1)

... mbi 100-vjetorin e Misionin Holandez të paqes së vitit 1913-14, në të cilin, mbështetur në të dhënat e reja historike nga burimet holandeze, shpjegova se ushtaraku i famshëm holandez, koloneli Tomson, nuk është vrarë nga shqiptarët në Durrës më 15 qershor të vitit 1914. Shkrimi im ishte krejt i pafajshëm dhe as kishte ndonjë lidhje me vlesën politike të kohës, dhe as ndonjë qasje për të dekriminalizuar dumbabasët, të cilët, jo nga ndonjë dashuri e madhe ndaj holandezit, por sepse nuk e kanë pasur në arsenalin e tyre snajperin e sofistikuar me çka dyshohet se është vrarë koloneli ynë i dashur, nuk janë vrasësit e tij. Kaq u desh, që makineria shtetërore, e njëjtë me atë që është edhe sot, të komandonte baltaçin shqiptarë dhe t'i detyronte ca personazhe lëtrë të medias shqiptare, që të mësuar të hanë në të gjitha pushtetet, organizuan për të zotët e tyre të politikës një fushatë të ulët denigruese ndaj meje. Sigurisht, përveç shijes së keqe që të vjen nga kolegë që fshihen me pseudonime, që të kërcënojnë se po i bën dëm Shqipërisë duke na "i mërziur" holandezët, nuk u shqetësua shumë, as atëherë, as sot, kur këto fakte të vërteta do të dalin së shpejti në dritë me botimin e biografisë së Kolonel Tomsonit. Sikur të mbetej vetvoja e Holandës për të hyrë në Europë në dorën time, i siguroj marionetat e pushtetit se ne do të ishim tani në Europë.

E përmdena këtë fakt jo pa qëllim. Këto ditë, në një artikull të botuar në një prej gazetave më të rëndësishme holandeze, gazetari që analizonte mocionin e parlamentit holandez për kthimin e regjimit të vizave për qytetarët shqiptarë, me një padije të thellë ndaj historisë, e mbase edhe me shijen e hidhur raciste në penën e tij, i përshkruante pak a shumë mes të tjerash shqiptarët "si të dhunshëm, si kishin vrarë dikur kolonel Tomsonin", arsye pse ata duheshin kufizuar për të pasur liri të plotë veprimi nëpër Europë, veçmas në Holandë e tij të kërcënuar nga këto banda, që i kujtonin atij plaçkitjet pirate të një shekulimi më parë.

Por, që të kthehem të çështja themelore e këtij shkrimi: kërkesa e kthimit të regjimit të vizave për shqiptarët dhe perceptimi shqiptar, dhe holandez mbi këtë lëvizje të policisë, prokurorisë dhe parlamentit holandez. Në krye të argumenteve të mia, dua të shpreh trishtimin tim të thellë për debatin e hapur mbi këtë çështje në Holandë, bashkë me përpjekjet për ta legjitimuar këtë iniciativë, por njëherësh kam bindjen se Europa që ne aspirojmë, nuk do ta lejojë një precedent të tillë, madje edhe Holanda, një nga vendet vërtet mike të Shqipërisë, nuk është se ndihet aq komode me këtë iniciativë që cenon thelbin e arkiteturës së saj të lirisë dhe demokracisë.

Këto ditë kam parë shumë rea-



gime mbi këtë çështje nga njerëz të thjeshtë, intelektualë, por edhe politikanë të lartë shqiptarë, dhe disa prej tyre janë vërtet për të ardhur keq. Po ç'faj na ka Holanda?

Të mos e shohësh siç duhet situatën dhe të kërkosh fajin të Holandës, dhe ata që janë të lidhur me Holandën, është e turpshme dhe diabolike, por edhe fyese për shqiptarët e thjeshtë, të cilët në fund të fundit do të jenë ata, që do t'i vuajnë këto zhvillime. Pasi, politikanët shqiptarë dhe kriminelët, një gjë e kanë të përbashkët: dinë se si t'i hapin rrugë vetes dhe t'i krijojnë përfitime për të lëvizur në Europë të lirë. Sigurisht, mocioni që u paraqit parlamentit holandez për rikthimin e regjimit të vizave për shqiptarët, nuk përputhet me pikëpamjet e Ministrisë së Jashtme Holandeze, e cila duke qenë më pranë humorit evropian, e di mirë se kjo është thuajse e pamundur. Kjo kërkesë duhet parë si një zille alarmi, qoftë edhe si një kërcënim i hapur dhe duhet t'i bëjë politikanët shqiptarë, qeverinë shqiptare në veçanti, që t'i shohë gjërat në një perspektivë më realiste dhe jo të përpjetat ta gjuajë shukun e fajit në oborrin e tjetërkujt.

Por, gjëja më qesharake që kam dëgjuar ishte shënimi i një politikani të lartë të partisë në pushtet, sipas të cilit, kjo situatë e re në raportet me Holandën ka ardhur nga ndërhyrja personale e kryetarit të opozitës, si holandez që qenëkës. Kam parë shpesh edhe ta etiketojnë si "Lul holandezit", sigurisht në kuptimin pexhorativ, a thua se të jesh holandez është një gjë e turpshme. Këto lloj etiketimesh që mund të duken si raciste, janë në fakt tregues i nivelit të diskursit politik në Shqipëri, që shkon në kufijtë e bajatës. Shqiptarët të luten madje që shefi i opozitës të jetë ca holandez, se kjo do t'i bënte mirë mjedisit politik shqiptar. Mbase edhe mund të jetë vërtet ca holandez, dhe kjo duket se i shqetëson radikalët, përderisa deri tani protestat e opozitës nuk

kanë gjenuar dhunë të vërtetë, siç jemi mësuar të shohim prej gati tridhjetë vjet, por janë thjesht përpjekje për përshkallëzim proteste, që është një gjë mëse e natyrshme në pjesëmarrje të të tilla përmasave. Dhuna vetëm do ta përligje veprimin e juntës që po ngrihet pa kuptuar, që edhe kaq sa është shfaqur, është një kërcënim i hapur i demokracisë shqiptare.

Fajin e Holandës duhet ta kërkojmë të shtëpia jonë, që ka filluar të na pikojë dhe po na zë brenda. Shqetësimi i policisë dhe prokurorisë holandeze mbi rritjen e kriminalitetit shqiptar në Holandë është bërë akut. Deri tani, kriminelët shqiptarë në Holandë janë marrë thjesht me drogë të lehta apo me trafik njerëzor nëpër portet holandeze, por prej disa vitesh ata zënë vendin e parë në trafikun e drogës në Holandë, veçmas në trafikun ndërkombëtar të kokainës. Ky kontingjent kriminal nuk pret lehtësirat europiane për të lëvizur i lirë dhe as do të kenë ndonjë shqetësim nga vendosja e regjimit të vizave me Holandën, pasi ata shëtitin lirshëm me pasaporta europiane dhe mund të korruptojnë me shumat që qarkullojnë këdo që u del përpara. Tani kriminelët shqiptarë kanë mbretërimin e tyre të kontrolluar të drogës brenda mbretërisë së Holandës, e cila nuk po i kontrollon dot më; aeroportëve, rrugëve, zyrave e nëndeshave të Amsterdemit, shqiptarët - edhe ata të pafajshmit - janë njerëzit më të dyshuar, më të survejuar sot. Vetëm në tri vitet e fundit janë arrestuar rreth 1700 shqiptarë si të dyshuar për trafikun e kokainës, si një kërcënim i hapur për Holandën. Dikur sherpa të italianëve dhe trafikantëve nga vende të tjera, tani ata komandojnë një rrjet shumë të sofistikuar në Holandë.

Kuptohet që mocioni mbi regjimin e vizave për shqiptarët është vetëm një masë profilaktike për të frenuar sado pak përshkallëzimin e tij, njëlloj siç ndodhi me masat që u morën për kufizimin e krizës financiare të importuar nga

Greçia, para se cilës Holanda u gjend e përgatitur në kohë. I gjithë shqetësimi i policisë, prokurorisë dhe politikës holandeze është pasoja që vjen nga ky "agresion": korruptimi i mundshëm i politikanëve holandezë - njëlloj siç dihet botërisht se janë politikanët shqiptarë - për shkak të këtyre shumave kaq marramendëse që janë ose pritet të jenë në qarkullim. Askush nuk është imun nga e keqja dhe krimi, ndaj higjiena e demokracisë së tyre është beteja e parë holandeze, ata nuk do ta lejojnë kursesi t'u helmohet demokracia e tyre nga elementë kriminalë, me në krye shqiptarët.

Por si shkuam deri këtu? Pse vitet e fundit kjo është bërë kaq e qartë? Prej vitesh jam shprehur me shqetësim në shënimet e mia mbi politikën e ditës, se kthimi i Shqipërisë nga Lazarat në Gjitharhat do të sillte pasoja të pariparueshme për Shqipërinë, pasi të futurit në lojë të shumave aq të mëdha parash ia bën shumë më të lehtë eksponentëve kriminalë të futeshin në tregun ndërkombëtar të drogave të forta dhe të kontrollojnë sot rrjetin në Europë, veçmas në Holandë përmes porteve të saj. Projekti shtetëror i kanabizimit të vendit, që u bë me bekimin e heshur dhe të hapur të qeverisë shqiptare, së cilit iu vu në shërbim edhe një pjesë të infrastrukturës shtetërore, e mbulluar mjeshtërisht me një propagandë të paparë deri më sot në raport me Europën, krijoi shtratin e një përmbyseje financiare kombëtare. Shihni nivelin e euros sot për të kuptuar se ku është Shqipëria në raport me Europën.

Por, dëmi më i madh që do të bëjë ky mocion është pasoja që do të japë për heqjen e regjimit të vizave për Kosovën, pasi situata e krijuar nga Shqipëria sot, do ta bëjë edhe më të vështirë që të ndodhë kjo, sikurse qytetarët e Kosovës meritojnë.

Një dëm po aq të madh kësaj çështjeje i bëjnë edhe të ashtuquajturit mbrojtës dhe lobues për Shqipërinë, të cilët në pjesën më të

madhe të tyre në Europë dhe SHBA janë njerëz pa autoritet të mjaftueshëm, edhe pse të paguar mirë, shpesh një Zot e di se si. Pritet që ky mocion të sjellë shpejt një sërë masash edhe më të rrepta ndaj shqiptarëve në Holandë. Shpesh kam qenë dëshmitarë e radhëve të shqiptarëve nëpër aeroporte, duke më kthyer sërish ndjesinë e harruar të viteve të shkuara kur edhe vetë kam qenë atyre radhëve. T'i kthes sërish shqiptarët e thjeshtë në qytetarë të dorës së dytë në Europë, t'i bësh sërish objekt investigimesh dhe kontrollsh gati denigruese është mëkati i politikës shqiptare sot. Por kjo nuk mjafton, ky mocion do t'i bëjë të pazëshëm politikanët holandezë, asnjëri prej tyre nuk do të guxojë të flasë në favor të Shqipërisë.

Por çfarë është më shqetësuese e që druaj ta them, është se ky mocion parathotë një veto të mundshme të Holandës për çështjen e hapjes së negociatave me Shqipërinë. Dhe përgjegjësia për këtë bie drejtpërdrejt mbi qeverinë shqiptare. As joshjet, as dhuratat, as propaganda, lektisjet ndaj ambasadorëve të Europës (përfshirë edhe ato të Holandës), as mbjelljet e pemëve me të deleguarit e Holandës, të cilët, edhe pse vinin të ngarkuar me shqetësimet për rritjen e kriminalitetit, iu shiten shqiptarëve si duartrokitje për sukseset, as propaganda ekstreme kundër opozitës dhe lidershipit të saj, si dëmtesija e reputacionit të zhvillimit të Shqipërisë, as farsiteti i përditshëm që emetohet nëpër ekranet e kapura të medias shqiptare nuk e mbulojnë dot korruptimin e plotë shtetëror që ka çuar në një ethe shqiptare për ta lënë Shqipërinë. Por për kundër kësaj, më vend të një reflektimi të thellë dhe gjetjen e rrugëve për të ndryshuar situatën, shpesh të deleguarit holandezë janë shqoëruar nëpër pritjet e tyre me sarkazmën e autoriteteve më të larta shqiptare, se Holanda nuk mund të japë leksione për drogat, sepse e ka në shtëpinë e saj. Kjo arrogancë e përbindshme dhe përdhushme i ka bërë shërbimin më të keq shqiptarëve.

Ku shkon e gjithë kjo para që qarkullojnë nëpër Holandë sot? Ktheni kokën dhe shihni sa grupa janë hapur në qendër të Tiranës, ato janë kozmetika e atij trafiku që sot komandon rrugët tona me Europën, që ka toksifikuar median, që ka akaparuar shtetin shqiptar, që sikurse mbreti lakuriq, nuk e sheh dot zhveshurinë e vet, as varfërinë që ka pllakosur shqiptarët prej këtij polarizimi të skajshëm, që nuk e kupton dhe as ka dëshirë ta kuptojë këtë çangë evropiane që po i bie në derë. Ajo, qeveria shqiptare, po përpiqet të gjelë fajtorët të tjerë, si përherë, sikur ia kanë mësuar etërit e tyre, tek "armiku i jashtëm", i cili nuk po arrin ta kuptojë se sa shumë përdëllim ka politika shqiptare për një Shqipëri evropiane. Në fund të fundit, ai që do të vuajë sërish do të jetë shqiptari i thjeshtë, ëndrra evropiane e të cilit nuk është ende tunikë e mjaftueshme për ta mbajtur të sigurt, sepse izolimi e kërcënon sërish.

18 prill 2019

Opinioni *i* Ditës

Mos e thërrisni më Rudina e Azemit

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

.. ka asgjë të përbashkët me Azemin, përpos mbiemrit.

Ajo është e brishtë, ai ishte i vrazhdë. Ajo ka armë buzëqeshjen, ai s'e ndante koburen nga brezi.

Ajo vjen në politikë nga një edukim perëndimor, ai qëndronte aty edhe falë lidhjeve me botën e kimit.

Ajo është tallur shpesh nga kundërshtarët, si më e kultivuar sesa duhet, ai se e shprehte hapur mungesën e kësaj dhuntie.

Rudina nuk ka vizion historik për misionin e saj, Azemi besonte në ringjalljen e Mujit dhe Halilit në ditët e sotme.

Por, pavarësisht nga këto dalime, në këtë botë ku logoja është gjithçka, Rudina Hajdari nuk po shkëputet dot, nga pesha e "markës" që mban mbi supe.

Kur Basha e katapulti në parlament në zgjedhjet e 2017, kritikët e tij brenda PD dhe armiqtë e opozitës e panë këtë si shembullin tipik të përdhunimit të meritokracisë. Për ta, ajo ishte aty thjeshtë si vajza e babait. Të dyja palët, në një kor të përbashkët, ripostonin në media gafat në parlament, sikur donin të theksonin se politika nuk është një talent që trashëgohet.

Sot rolet kanë ndryshuar. Përndjekësit e djeshëm e kanë shndërruar në heroinë, kurse opozita zyrtare e ka shpallur tradhtarë të idealit të Azemit, duke inskenuar edhe fabulën e shëmtuar të kundërvënies së vëlait ndaj motrës.

Këto anateme nga ish-krahu i saj politik do të shtohen me siguri në ditët e ardhshme, tani që Rudina ka marrë rolin e lideres së grupit të PD, dhe ka folur për përfaqësimin e çetës së të mosbindurve në zgjedhjet e qershorit.

Po a duhet gjykuar Rudina për zgjedhjet e saj? A përbën sot një mëkat mos i bindesh urdhrave të kryetarit të partisë? A ka të drejtë të ndjekë një rrugë të ndryshme, qoftë nga ajo që predikon Basha, apo qoftë nga ajo që kanë votuar masivisht forumet e PD?

Natyrisht që PO. Megjithëse personalisht jam një nga ata që e ka mbështetur opsinin e djegies së mandateve si të vetmen zgjidhje, megjithëse e shoh si idiotësi pjesëmarrjen e opozitës, me Ramën kryeministër, në zgjedhjet e qershorit, e quaj të pamoralshëm madje demokratikisht të rrezikshëm, linçimin që po i bëhet Rudinës si tradhtarë e partisë dhe kujtimin atëror.

Politikisht, si vajzë, ajo është në të drejtën e saj legjitime të "vrasë



babain".

Moralisht, atë s'e pengon askush të jetë kundër rrugës me të cilën Lulzim Basha po drejton partinë, apo zgjedhjes së tij plot enigma për të djegur mandatet. Deri këtu Rudina Hajdari nuk mund të akuzohet, as për zdhërlallje në shtratit e armikut, as për besëthyerje troyane.

Problemi i saj qëndron tek hipoteza që sapo shpalli, për të hyrë në zgjedhje. Sepse të gjithë e imagjinojnë lehtësisht se si do të jetë gara elektorale, nëse opozita vendos të mos marrë pjesë. Ajo do të ketë ngjyrat dhe formën e një farse. Aty nën panikun për të ruajtur një demokraci fasadë, Edi Rama do të manipulojë vota nga

do. Ai nuk do të përpigjet të rrisë vetëm pjesëmarrjen, por do të tregohet bujar edhe për të falur përqindje për opozitën e re. Pra, shkurt, ai do të tentojë të bëjë atë që deshi të realizojë Ramiz Alia para se Azem Hajdari të dilte në rrugë: një pluralizëm fals, ku PPSH-në do ta konkurronin levat e saj, Bashkimet Profesionale, Bashkimi i Rinisë dhe Bashkimi i Grave.

Vetëm në këtë rast Rudina Hajdari do ta tradhtonte imazhin e Azemit. Dhe kjo jo për fjalorin, mënyrën e të bërit politikë apo stilin e përcimit të saj. Aty ajo është e lirë ta vrasë babain. Por, nëse ajo mbështet pluralizmin fals që po kërkon të rivendoset pas tri dekadash, aty ajo shkel

mbi një vokacion, mbi një ndarje thelbësore që shkon përtej mosdakordësisë me Bashën, Berishën apo kujtimin atëror.

Pra, nëse deri më tani, me të drejtë, ajo ka dëshmuar se nuk kërkon të jetë në politikë vetëm falë parodisë elektorale, ajo rrezikon shumë më tepër. Ajo distancohet dhe nga i vetmi akt i pastër dhe i pa kundërshtueshëm me të cilin Azem Hajdari do mbetet në histori: vendosja e pluralizmit politik.

Vetëm në këtë rast ajo e meriton çdo lloj epiteti që i kanë vendosur padrejtësisht paradhënje. Sepse vetëm ashtu ajo nuk do të jetë më Rudina e Azemit.

©Lapsi.al

HOROSKOPI

DASHI

Disa njerëz po tentojnë t'ju tregojnë se si ta udhëhiqni jetën tuaj, por ata nuk dinë asgjë rreth jush. Sigurisht, është mirë që t'ju ofrojnë këshilla, por askush nuk e di se çfarë ju nevojitet më shumë se sa ju.

DEMI

Ndërkohë që jeni të zënë duke i frymëzuar të gjithë rreth jush sot, veprimet tuaja pa dashje do të vendosin një ide në lëvizje, duke bërë shumë njerëz të lumtur. Shfrytëzoni këtë energji pozitive edhe në çështjet e dashurisë.

BINJAKET

Me mendjen e fokusuar tek e ardhmja, do të mund të shihni se si gjërat do të jenë shumë më të lehta së shpejti, veçanërisht në aspektin profesional. Mjafton t'i bëni gjërat me qetësi dhe gjithçka do të jetë në favorin tuaj.

GAFORJA

Ju keni ndërtuar një reputacion si dikush që me të vërtetë e di se çfarë po bën, duke qenë se shumë njerëz drejtohen tek ju kur kanë nevojë për përgjigje. Por, sot do të jeni në anën tjetër. Mos humbini kohë, por kërkonin ndihmë. Suksesi juaj varet nga kjo.

LUANI

Imagjinojeni suksesin dhe do ta keni shumë më të lehtë për ta arritur. Gjithçka ka të bëjë me të menduarit pozitiv dhe besimit te vetja. Për të ndërtuar besimin, rritni afër njerëzve që nxjerrin më të mirën te ju.

VIRGJERESHA

Luani në mënyrë të zgjuar sot dhe do të shpërbleheni financiarisht. Mos i tregojni të gjitha sekretet tuaja të njerëz, të cilët shtrihen si miq kur e dini mjaft mirë se ata kanë qenë pengesa kryesore për suksesin tuaj.

PESHORJA

Të gjithë do të vijnë tek ju me problemet e tyre sot, por për fat të mirë nuk do të bezdiseni aspak! Natyra juaj empatike i bën të gjithë të ndihen kaaq të relaksuar dhe u mundëson atyre të hapen e të thonë atë që është më të vërtetë në mendjen e tyre.

AKREPI

Duket se të gjithë përveç jush e dinë se ju jeni një yll i vërtetë 'roku'! Sot do ta shikoni veten në pasqyrë dhe do të thoni me bindje se shkëlqeni. Shfrytëzoni këtë moment të mirë për të realizuar planet dhe projektet që keni.

SHIGJETARI

Është koha që të përqendroheni te kursimi në vend të shpenzimeve. Asnjë blerje nuk mund t'ju bëjë më të lumtur apo më tërheqës. Ruajini paratë dhe jini krenarë për vetëdijimin tuaj.

BRICJAPI

Ndonjëherë është e vështirë të dini se sa informacion duhet të ndani dhe sa duhet të ruani për vetë. Kështu që tregohuni i zgjuar dhe mos tregoni asgjë. Sa i përket një çështjeje romantike, gjatë duket se po ecin me ritmin e duhur sot.

UJORI

I rëndësishëm është udhëtimi, jo destinacioni. Shijojeni ditën, e cila është e mbushur me surpriza dhe aventura. Nëse nuk bëni një ndalesë në mënyrë që të vlerësoni gjërat që keni bërë me sukses, atëherë cili është qëllimi?

PESHQIT

Për të ruajtur energjinë tuaj dhe qëndrimin pozitiv, rrethojeni veten me njerëz të cilët janë pozitivë dhe ju duan. Shmangni negativitetin nga jeta juaj, duke larguar personat të cilët mbjellin xhelozsi dhe inat.



Shkodrani do të jetë asistent i trajnerit kuqezi

Hamdi Salihi, pjesë e stafit të Edoardo Rejas

Më duhet pak kohë për të njohur skuadrën dhe si punohet në federatë". Kjo ishte një nga deklaratat e Edi Rejas gjatë prezantimit si trajner i Kombëtares së Shqipërisë. Por, për ta përshpejtuar këtë proces, teknikun do të ketë ndihmën e një perso-

ni që ka luajtur gjatë dhe një shumëllojshmëri përfaqësueses kuqezi. Përveç Ervin Bulkut, tashmë pjesë e pandarë e stafit teknik, në krah të Edi Reja do të jetë edhe Hamdi Salihi. Ish-sulmuesi u tërhoq nga futbolli vetëm pak javë më parë,

duke njoftuar nisjen e një aventure të re. Burime të "BalkanWeb" pranë Federatës Shqiptare të Futbollit bëjnë të ditur se shkodrani do të jetë pjesë e stafit të trajnerit të ri në Kombëtaren e Shqipërisë. Hamdi Salihi pati një takim me teknikun

italian menjëherë pas prezantimit të tij zyrtar në pankinën kuqezi, ndërsa edhe gjatë paradites të së enjtes, të dy ata janë parë bashkë. Ende mbetet për t'u mësuar se cili do të jetë roli i ish-sulmuesit në stafin teknik të përfaqësueses, megjithëse me shumë mundësi, mund të ketë një detyrë të lidhur me përgatitjen e sulmuesve. Një rol i tillë i ishte besuar Erjon Bogdanit në vitet e para të Xhani De Biasit në pankinën kuqezi.

Alegri është në pikëpyetje, Kosta, Pjaniç dhe Dibala janë me 'valixhe në duar'

Dështimi sjell revolucionin, në dyshim edhe Cristiano Ronaldo

Te Juventusit mendojnë ndryshime të mëdha



Eliminimi në Champions League dhe titulli në Serie A i hipotekuar i detyron drejtuesit e Joves të mendojnë që tani për të sezonin e ardhshëm. Pikëpyetja më e madhe ka të bëjë me Ronaldon, fenomeni portugez është nën kontratë me "Zonjën e Vjetër" deri në vitin 2022, nëse nuk largohet në fund të sezonit, e sigurt është se nuk do të qëndrojë deri në fund të kontratës, nga Amerika mund t'i paraqesin një ofertë të parezistueshme. Pikëpyetja tjetër ka të bëjë me të ardhmen e Alegrit, drejtuesit e klubit nxituan për ta konfirmuar në përfundim të sfidës kundër Ajaksit, por gjërat mund të ndryshojnë shumë deri në fund të sezonit, Konte qëndron pas porte për të shfrytëzuar çdo rast. Një largim i sigurt është ai i mbrojtësit Barzajit, Juve duhet të futet në merkato për ta zëvendësuar. Douglas Costa gjithashtu është me valixhe në duar,



briljanti nuk arriti kurrë të përshtatej as në Torino.

Gjithashtu, statusin si të paprekshëm e ka humbur edhe

Miralem Pjaniç. Nuk është aspak e sigurt as e ardhmja

e Dibalas; nëse Alegri qëndron, largimi i tij është thuajse i sigurt. Në hyrje, emri më i rëndësishëm që po qarkullon së fundmi është ai i Salah. "Faraoni" egjiptian me sa duket ka prishur marrëdhëniet me Klop, nëse do të largohet nga Liverpooli në fund të sezonit, Juve do të provojë ta bindë. Mauro Icardi mbetet gjithnjë një temë e hapur. Për sa kohë Interi nuk e ka blinduar, argentinasi mbetet një kandidat për sulmin bardhezi. Për mbrojtjen, dy kandidatë vijnë nga La Liga. Varane është një emër që josh shumë "Zonjën e Vjetër", një mbrojtës që i shkon përshat mënyrës se si Juve luan futboll, në Torino do të ishte i mirëpritur për sa kohë Realit ka vendosur ta nxjerrë në shitje, emri tjetër është ai i Umтитi, mbrojtësi i Barcelonës.

VENDIMI

Turpëroi Shqipërinë, Skocia shkarkon trajnerin MekLish

Emrat që të shkojnë në mënyrë mend janë shumë, pasi Kristian Panuçi mori rezultate vërtet zhgënjyese në krye të Shqipërisë, në disa raste edhe gola, të cilët mërzi të jo pak tifozët e Kombëtares, që ishin mësuar me tjetër lojë e tjetër rendiment të ekipit kuqezi. Por, ai që është shkarkuar, quhet Alan MekLish, trajneri i Skocisë, i cili triumfoi të dyja ndeshjet ndaj Shqipërisë me rezultatin 2-0 dhe 4-0, ku padyshim pokeri i pësuar në "Loro Boriçi" ishte edhe më i dhimbshmi për tifozët kuqezi. Humbja 3-0 në Kazakistan nuk është përtypur nga drejtuesit e Federatës së Skocisë, që kanë vendosur të shkarkojnë trajnerin, nën drejtimin e të cilit Skocia arriti rezultatin më të mirë të 20 viteve të fundit, duke u renditur e para në Ligën C të Nations League.

Nuk kanë fund dënimet e FSHF-së, por dhuna në futbollin shqiptar vijon të prezente në forma të ndryshme. Pezullimi ekzemplar i Kanzës nuk ka pasur asnjë efekt, këtë herë dhuna u shfaq në Kategorinë e Parë në sfidën Besa-Bylis, një ndeshje e cila nuk u luajt deri në fund, pasi tifozët goditën me sende të forta gjyqtarët e këtij takimi dhe shkaktuan akte dhune. Me këtë motivacion, Komisioni i Disiplinës ka dënuar ekipin e Besës me humbjen e ndeshjes në tavolinë me rezultatin 3-0, gjithashtu është e detyruar të luajë 8 ndeshje pa tifozë në stadiumin përkatës. Pjesë e vendimeve të Komisionit

Tirana do ta konvertojë në gjobë dënimin e sulmuesit

FSHF shkërmoq Besën, rrëzohet kërkesa e Ngo për falje




të Disiplinës ka qenë edhe sulmuesi i Tiranës, Majkell Ngo. Disiplina nuk ka marrë parasysh kërkesën e gjigantit anglez për faljen e pjesës së mbetur të dënimit prej 5 ndeshjesh, duke e kon-

sideruar këtë kërkesë si të pabazuar në Kodin e Disiplinës Sportive. Në këtë kushte, klubit bardheblu nuk i mbetet gjë tjetër vetëm të shlyejë me gjobë pjesën e mbetur të dënim-it, pasi Ngo është i domosdoshëm për kryeqytetasit në këtë fundsezon. Drejtuesit e klubit të Tiranës e kanë konfirmuar këtë lajm, konvertimin e dënimin me gjokë. Ngo u pezullua me 5 ndeshje pas konfliktit verbal që pati me presidentin e Laçit, Pashk Laska.

Planet e Solskajer ranë në duart e "armikut"

Rashford humbi letrën, Ter Shtegen zbuloi strategjitë e Junajtidit




ka rënë në hyrje të zonës katalanas, portieri Ter Shtegen nuk ka rezistuar dot

dhe është afuar për të parë se çfarë kishte shënuar tekniku i "Djaveve të Kuqe", duke "spiunuar" kështu në një farë mënyre kundërshtarët. Në letër ishte një udhëzim ndaj skuadrës për të ndryshuar rreshtimin në fushë, por letra përfundoi në duart e gabuara. Një moment që nuk është humbur nga telekamerat tekta video e gardianit të Barcelonës është kthyer virale në rrjetet sociale.

Një moment interesante është regjistruar në "Camp Nou", në sfidën e Ligës së Kampionëve mes Barcelonës dhe Manchester Junajtid. Janë të shumta mënyrat që trajnerët kanë gjetur për të udhëzuar futbollistët në fushë për strategjitë ndaj kundërshtarit apo lëvizjet e skemave gjatë lojës. Një përpjekje të tillë ka bërë edhe trajneri i Junajtidit, i cili ka shkruar një copë letrë tekta ia ka dorëzuar Rashford, por sulmuesi nuk është treguar i kujdesshëm, tekta e ka humbur pas një dueli me Pikenë. Me letrën e cila

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. I famshëm ai i Delfit.
8. Ai elektoral që duhet kapërcyer.
13. Një raketë... atdhetare.
14. Val aktor.
15. Kazan regjisor.
16. Pak formalitet.
17. Eshhtëa Au në tabelë.
18. Të fundit në surf.
19. I mbjell... katastrofa.
24. Fillojnë masat.
25. I bëjnë të luajturit.
26. Mbyllin një krah.
27. Janë trupa qiellore.
28. Preferojnë yjet e hënën.
29. Vanessa violiniste.
31. Beton pa kufij.
32. Ente Operative Tiranë.

33. Winslet aktore.
34. Një stacion... anijesh.
36. Atëherë kur dalin yjet.
39. Një djalë vajze.
40. Këndohet në opera.
41. Pak elementare.
42. Një pjesë e origjinës.
44. Eshhtë bota jashtë ëndrrës.
46. Eshhtë shuma e përgjithshme.
48. Totale pa zë.
49. Merret me të bukurën.

VERTIKAL

1. Eshhtë melodramë.
2. Një Schumacher... jo kampion.
3. Ai i shenjtë është Papa.
4. Lidhet në... fyt.
5. Arturo i Brecht.
6. Fillojnë lojën.
7. Luhet në ekstreme.
8. Kishin flamurtë zi.
9. Role pa zë.
10. Pak amatoriale.
11. Eshhtë shkronjë.

12. Personazh i Dickens.
14. Ishin bashkitë dikur.
16. Eshhtë edukimi në palestër.
20. Papas aktore.
21. Qytet italian.
22. Një pëllhurë sintetikë.
23. I bëjnë testet me një set.
25. Një monument... për kujtim.
27. Mund të jenë me katër kohë.
28. Një ushtarak me... numër.
29. Kryeqyteti i Filipineve.
30. Ai i shenjtë është papa.
35. Një pjesë e talenteve.
37. Numri i oktetit.
38. Eshhtë sport me stil të lirë.
43. Gjysmë raketë.
45. Ekstreme në ekstreme.
47. Fundi i turandot


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Eshhtë baba.
5. Të fundit në studim.
7. Gustave, piktori që ilustroi Komedinë Rijnore.
11. Lidhin brigje.
12. Mban në kokë një tiara.
14. Janë poezi.
16. Qetësonte detin.
17. Koloneli i shkurtër.
18. Inicialet e Mallë regjisori.
19. Mbeten në fund.
20. Qethi Sansonin.
22. Sateliti i Jupiterit.
23. Në mes të Tommy dhe Jones aktor.
25. Thirrej El Pibe de oro.
27. Eshhtë shkaktoni i sherrit.
29. Një vegël edhe Stradivari.
30. Fillojnë një periudhë.
31. Bukuroshja e Eunoës.

VERTIKAL


1. Eshhtë galeri në hekurudhë.
2. Një mund të jetë cirku.
3. Pishtarë pa pishë.
4. Matet pa kufij.
5. Mbyllin një princip.
6. Mund të jenë spaghetti të tilla.
7. Këndonte Ciao amore ciao.
8. Prodi që u pasua nga Berlusconi.
9. McBain shkrimtar.
10. Eshhtë shtypja në barometër.
13. Ishte kombësia e Chopin.
15. Fara këngëtare.
20. Vrau Goliathin.
21. Një i mbijetuar nga Sodoma.
24. Janë noftka.
25. Eshhtë frut i shërit.
26. Në krye të arnatisë.
28. Teket e një rrote.
29. Kilmer aktor.
30. Përhapet me frikë.
31. Parashtesë zmadhuese.
32. Në krye të komandës.
33. Afrohen nga kreu.
34. Ishte futbolli i famshëm për një gjethë të thatë.
37. Ndiqet me ilaçe.
39. Agjenci Martësore Rumune.
41. Kastile janë në fund.
44. Hapen në kufij.
45. Fund janari.
46. Inicialet e Gide.
48. Të parat në olimpiadë.
49. Në krye të titullarëve.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

		1		4	8				
	9	2							
	1		4			5	9		
8		4	1						
3	9				6				
	5			8		4			
	8		6						
6			1						
					7		2		

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

2	9	4	1	3	5	8	6	7	
6	1	3	8	7	2	9	5	4	
5	7	8	4	9	6	1	2	3	
7	6	5	9	1	4	2	3	8	
3	8	9	5	2	7	6	4	1	
1	4	2	3	6	8	5	7	9	
8	2	6	7	4	9	3	1	5	
9	3	7	6	5	1	4	8	2	
4	5	1	2	8	3	7	9	6	

Argëtim filozofik

- Tri gjëra e karakterizojnë njeriun e mençur: Së pari, bën ato që këshillon të tjerët të bëjnë. Së dyti, nuk bën asgjë që është në kundërshtim me të vërtetën. Së treti, është i durueshëm me dobësitë e të tjerëve.

- Nëse një pemë bie në pyll dhe askush nuk është atje për ta dëgjuar atë, do të bëjë zhurmë?

- Një hap i vogël për njeriun, një hap i madh për njerëzimin.

Thënie të mençura

- Nuk më shqetsojnë muret që kanë veshë, por veshët që kanë mure...
- Një njeri optimist beson se jetojmë në botën më të mirë të mundshme. Një pesimist ka frikë se kjo është e vërtetë.
- Shumë justifikime janë gjithmonë më pak bindëse se një.
- Çdokush që ka përjetuar një dashuri të madhe, nuk i jep rëndësi miqësisë.

PËRGIJQIET E FJALËKRYQIVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

K U R S I M I P T N D
 A N K A D I V A N A
 L O T E P T R E N A T
 I H I P O K R A T I M
 A E R O S T A T I D E
 D T K A S T E R E T N O R
 E D U I A E R E N E T
 T A R E L E R T A N D E T
 A N A E U T A N A S I A
 K T I R I M O N I S J A
 E T I R O N I S J A
 T S P A A K L A E R T I

FJALËKRYQI (2)

M I S S U A B D E R A
 I L K F R O B E R T O
 T P E R R A L L A N D I R
 K A N E L L E T A I R
 R E P A R T E N S A O
 T A R E S T I P N
 H E R E T T R U K E T I
 O R E T R E A L K U P A
 R E T I T I N E T
 K E N D O M N E T E T R
 A H O T E L E T T R I O
 T I K A T E R A R M

